



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raporti i auditimit të ushtruar në Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare për projektin “Fuqia energjitike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit”**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**MBI**

**“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”**

**NË**

**KORPORATËN ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE  
PËR PROJEKTIN “FUQIA ENERGJITIKE DHE SIGURIA E DIGËS NË  
KASKADËN E DRINIT”**

**TIRANË, nëntor 2025**

<b>NR.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	5
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>6</b>
1	Objektivat dhe qëllimi	6
2	Identifikimi i çështjes	6
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4	Përgjegjësitë e audituesve	7
5	Kriteret e vlerësimit	7
6	Standardet e auditimit	7
7	Metodat e auditimit	7
8	Dokumentimi i auditimit	7
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>8</b>
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	8
2.1	Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimit i ndryshimeve.	8
2.2	Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.	12
2.3	Mbi menaxhimin financiar të programit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave	14
2.4	Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të prokurimit të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacioni shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.	19
2.5	Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra dhe konsulencë.	44
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>45</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
IDA	Shoqata ndërkombëtare për zhvillim;
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim;
SECO	Qendra e Konfederatës Zvicerane;
KfW	Instituti i Kreditimit të Investimeve Gjermane;
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
AK	Autoriteti Kontraktor
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
sh.a.	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

### I. 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. Përshkrim i shkurtër i Projektit: *“Fuqia energjitike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit”*, është projekt i cili është financuar nga Banka Gjermane e Zhvillimit (KfW) në vlerën 20 milion euro, aprovuar me ligjin nr.87/2015, datë 23.07.2015 *“Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunimin Financiar, për projektin “Energjia Ujore dhe Siguria e Digave në Kaskadën e Drinit”* të datës 30.06.2015, me afat disbursimi 30.06.2015-31.12.2018, i cili më pas u zgjat deri më 31.03.2024.

Agjencia Zbatuese e Projektit është KESH SHA e cila ka përdorur Kredinë për Rehabilitimin e kanaleve të derdhjes në hidrocentralin e Vaut të Dejës, implementimin e një Qendre Monitorimi dhe Dispeçerimi të digës, shërbime konsulence, pjesë e Projektit të Përgjithshëm të Sigurisë së Digave.

Në implementimin e projektit, u konstatuan problematika në procesin e planifikimit të procedurave duke rezultuar më vonë në tejkalim të gjithë afateve të vendosura.

Në tërësi qëllimi i projektit është realizuar brenda vlerës së huasë. por jo në afatet e përcaktuara duke pasur shtyrje të afateve të disbursimit.

Në lidhje me procesin e dorëzimit të punëve civile dhe pajisjeve u konstatua se procesi i marrjes në dorëzim është kryer nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve sipas kërkesave të kontratës por nga ana e KESH procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve nuk është bërë në përputhje me nenet dhe pikat 42, 43 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

b. Rëndësia e Projektit. Projekti ka rëndësi për rritjen e sigurisë së kaskadës së Drinit, duke përmirësuar funksionalitetin e portave të shkarkimit.

c. Qëllimi i auditimit është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar, i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord; verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, i cili përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare; raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

#### Raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

-Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre.

-Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit.

-Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

-Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.

-Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave: Në varësi të specifikave të subjektit të auditimit, në programin e auditimit janë përdorur veçmas ose të kombinuara përdorimi i metodave dhe teknikave të mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve - kur është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, atëherë ky informacion mund të krahasohet me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër.

- Intervistimi - është metoda e marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet. Për shkak se kjo metodë mbart rrezikun e subjektivitetit është shqyrtuar nëse evidenca e arritur gjatë përdorimit të një metode të tillë është plotësisht e besueshme.

- Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve lidhet me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të. Raportet mund të tregojnë gjithashtu dhe vëmendjen që u është kushtuar mangësive të mëparshme, por që nuk është marrë asnjë masë për eliminimin e tyre.

- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm - audituesi duhet të marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.: Në përfundim të auditimit kanë rezultuar 7 gjetje dhe janë dhënë 9 rekomandime.

## **I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.**

### f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

-Nga auditimi mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit, konstatohet se ka pasur shtyrje të afateve të disbursimit duke e shtyrë në kohë realizimin e objektivave të projektit.

Nga auditimi rezulton se për shkak të zgjatjes së afatit të zbatimit të projektit, mos disbursimit në kohë dhe jo sipas skedulit të parashikuar në marrëveshjen e financimit të huasë të fondeve të vendosura në dispozicion, Ministria e Financave ka paguar ndaj KfW vlerën prej 382,498 euro, e cila është kosto shtesë për Ministrinë së Financave dhe KESH sha.

-Nga auditimi mbi zbatimin e disbursimeve dhe pagesave të kontratës, u konstatua se operatori ekonomik fitues nuk ka zbatuar rregullat dhe ligjshmërinë për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

-KESH sh.a., nuk ka respektuar skedulët e pagesave për huanë, duke detyruar Ministrinë e Financave si garantues të kryejë pagesat ndaj KfW.

-Në bazë të marrëveshjes së huasë është lidhur Marrëveshje e Nënhuasë nr. 7551/2, datë 06.01.2016 midis Ministrisë së Financave dhe KESH SHA ku detyrimet financiare të parashikuara në marrëveshje i kanë kaluar KESH SHA, por që për arsye të paaftësisë paguese, detyrimet ndaj KfW janë shlyer nga Ministria e Financave dhe KESH Sha ka një detyrim të mbartur ndaj Ministrisë së Financave në shumën 13,273,274 euro deri më datë 31.12.2024.

-Në lidhje me procesin e dorëzimit të punëve civile dhe pajisjeve u konstatua se procesi i marrjes në dorëzim është kryer nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve sipas kërkesave të kontratës, por nga ana e KESH procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve nuk është bërë në përputhje me pikat 42, 43 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë rekomandimet si vijon:

-Administratori i shoqërisë KESH sh.a., dhe Drejtori i drejtorisë financiare të marrin masa që në të ardhmen, operatorët ekonomik fitues të procedurave të prokurimit të fondeve me financim të huaj, në rast se në marrëveshjen e ratifikuar nuk është parashikuar ndryshe, të zbatojnë rregullat dhe legjislacionin fiskal të Republikës së Shqipërisë, me qëllim shmangien nga pagimi i detyrimeve tatimore që mund të krijohen gjatë zbatimit të marrëveshjeve kontraktore.

-KESH Sha në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrin masa për hartimin e një marrëveshjeve dhe skeduli për kryerjen e pagesave të detyrimeve të prapambetura të kësaj kredie. KESH Sha të marrin masa për parashikimin e fondeve për shlyerjen e huasë dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja në programin e saj ekonomik dhe financiar.

## **I.3. Konkluzioni i auditimit**

Projekti “Fuqia energjitike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit”, është në vazhdimësi të studimit të kryer në digat e lumenjve Drin dhe Mat, në periudhën 2006-2008, ku rezultoi se duheshin investime urgjente për të rritur sigurinë e digave në kaskadën e Drinit. HEC-i Vau-i-Dejës, në pozicionin e tij si hidrocentrali i fundit i kaskadës së lumit Drin, luan një rol të rëndësishëm në shkarkimin e prurjeve të ujit në periudhat me reshje të shumta për sigurinë e popullatës në pjesën veriore të Shqipërisë.

Një nga objektivat kryesore të projektit ishte rehabilitimi i strukturave ekzistuese hidraulike të derdhjes në digën e Zadejës dhe Qyrsaqit në rezervuarin e Vaut të Dejës, si dhe portave të shkarkimit për të siguruar funksionim të sigurt dhe të besueshëm të këtyre strukturave për dekadat e ardhshme. Gjithashtu në vijimësi të procesit të sigurisë në diga, u krye instalimi i sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të shkarkimit të ujërave nga digat në kaskadën e Drinit.

Për financimin e projektit u dakordësua të financohej nga KfW (Banka Gjermane e Zhvillimit) në vlerën 20,000,000 euro, me afat disbursimi 30.06.2015 - 31.12.2018, i cili më pas është shtyrë deri më 31.03.2024.

Nga auditimi për implementimin e projektit, u konstatuan problematika në procesin e planifikimit të procedurave të shërbimeve për konsulencë të rehabilitimit të strukturave ekzistuese dhe portave të shkarkimit, me pasoja në tejkalim të të gjithë afateve të vendosura. Në tërësi qëllimi i projektit është realizuar brenda vlerës së huasë, por jo në afatet e përcaktuara duke pasur sjellë për pasojë shtyrje të afateve të disbursimit. Ministria e Financave ka paguar ndaj KfW vlerën prej 382,498 euro komisione disbursimi, e cila është kosto shtesë për këtë projekt investimi.

Në bazë të marrëveshjes së huasë është lidhur Marrëveshje e Nënhuasë nr. 7551/2, datë 06.01.2016 midis Ministrisë së Financave dhe KESH SHA ku detyrimet financiare të parashikuara në marrëveshje i kanë kaluar KESH SHA.

Për arsye të paaftësisë paguese të KESH SHA, detyrimet ndaj KfW janë shlyer nga Ministria e Financave dhe KESH Sha ka një detyrim të mbartur ndaj Ministrisë së Financave në shumën 13,273,274 euro deri më datë 31.12.2024.

Në lidhje me procesin e dorëzimit të punëve civile dhe pajisjeve u konstatua se procesi i marrjes në dorëzim është kryer nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve sipas kërkesave të kontratës, por nga ana e KESH procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve nuk është bërë në përputhje me pikat 42, 43 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 315/1, prot., datë 12.03.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 12.03.2025 deri në datën 30.05.2025, në subjektin Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) për projektin “*Fuqia energjitike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit*” për periudhën nga fillimi i projektit deri në datën 31/12/2024 u krye auditimi “Mbi Përputhshmërinë e Projektit “*Fuqia energjitike dhe siguria e digës në kaskadën e Drinit*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. B. Sh., përgjegjës grupi
2. I. S., anëtare
3. M. G., anëtare
4. F. D., anëtar

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

### 1. Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Dhënia e konkluzionit dhe një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve si dhe nëse është kryer përdorimi i përshtatshëm i fondeve të projektit.

Raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

### 2. Identifikimi i çështjes:

Në auditimin e zbatimit të këtij Projekti janë identifikuar çështjet e mëposhtme:

-Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre.

- Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit.
- Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.
- Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.
- Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.
- Të tjera çështje të dala gjatë auditimit.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Njësia e Menaxhimit të Projekteve në Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) është përgjegjëse për koordinimin e punës, hartimin dhe ndjekjen e aspekteve teknike, ekonomike, mjedisore e administrative të projektit, supervizionin e tij deri në dorëzim.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjekteve të audituara lidhur me çështjet perkatëse. Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

### **4. Përgjegjësitë e audituesve:**

Përgjegjësia jonë është që të arrijmë në konkluzione në lidhje me implementimin e projektit shkallën e realizimit të objektivave etj. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

### **5. Kriteret e vlerësimit:**

- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.87/2015, datë 23.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunimin Financiar 2009, për projektin “Energjia Ujore dhe Siguria e Digave në Kaskadën e Drinit””, datë 30.06.2015.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 19.06.2019 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndryshuese të Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sha (Agjencia zbatuese e projektit), dhe KfW Frankfurt AM Main, për programin “Energjia ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit, ratifikuar me ligjin 87/2015.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **6. Standardet e auditimit:**

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;  
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC, etj.

### **7. Metodatat e auditimit:**

Auditim i njëpasnjëshëm, me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

### **8. Dokumentimi i auditimit:**

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt konstatimeve si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projekt

Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

### **III. PËSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i përgjithshëm:**

Për realizimin e projektit “*Fuqia Energjitike dhe Siguria e Digës në Kaskadën e Drinit*” është marr kredia nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë (KfW) në vlerën 20 milion euro, ratifikuar me ligjin nr.87/2015, datë 23.07.2015 “*Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunimin Financiar 2009, për projektin “Energjia Ujore dhe Siguria e Digave në Kaskadën e Drinit”*” të datës 30.06.2015.

Agjencia Zbatuese e Projektit (KESH) në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje, e ka përdorur Kredinë për:

- Rehabilitimin e kanaleve të derdhjes në hidrocentralin e Vaut të Dejës;
- Implementimin e një Qendre Monitorimi dhe Dispeçerimi të digës;
- Shërbime konsulence,

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 19.06.2019 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndryshuese të Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sha ...” me anën e të cilës janë miratuar zgjatja e afatit të kryerjes së pagesave deri 31.05.2021, si dhe ndryshimin e skedulit të pagesave dhe kësteve. Me shkesën datë 12.05.2021 të KfW-së është shtyrë afati i disbursimeve deri në datë 30.12.2021. Me shkresën nr. 9628/1, datë 30.05.2022 “Dërgohet kopje origjinale të marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë” Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka dërguar KESH sha marrëveshjen ndryshuese e cila parashikon zgjatjen e afateve të kredisë deri në 30.12.2023. Me shkresën datë 19.01.2024 të KfW-së është shtyrë afati i disbursimeve deri në datë 31.03.2024 pa kosto shtesë.

Në implementimin e projektit, ka pasur problematika në procesin e planifikimit të procedurave duke rezultuar më vonë në tejkalim të gjithë afateve të vendosura.

Në tërësi qëllimi i projektit është realizuar brenda vlerës së huasë. por jo në afatet e përcaktuara duke pasur shtyrje të afateve të disbursimit.

Në lidhje me procesin e dorëzimit të punëve civile dhe pajisjeve u konstatua se procesi i marrjes në dorëzim është kryer nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve sipas kërkesave të kontratës por nga ana e KESH sh.a., procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve nuk është bërë në përputhje me nenet dhe pikat 42, 43 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

#### **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:**

##### **2.1 Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimit i tyre.**

Në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 315/1, datë 12/03/2025 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Marrëveshjet e financimit të projektit
2. Raportet përkatëse të projektit “*Fuqia Energjitike dhe Siguria e Digës në Kaskadën e Drinit*”
3. Dokumentacioni i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në marrëveshje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Për realizimin e projektit “*Fuqia Energjitike dhe Siguria e Digës në Kaskadën e Drinit*” është marr kredia nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë (KfW) në vlerën 20 milion euro,

e ratifikuar me ligjin nr.87/2015, datë 23.07.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunimin Financiar 2009, për projektin “Energjia Ujore dhe Siguria e Digave në Kaskadën e Drinit” e datës 30.06.2015. Sipas kësaj marrëveshjeje Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ka mundësuar Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë për projektin “Energjia ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit” nga Kreditansalt für Wiederaufbau (KfW) një hua me kushte të favorshme, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlerë deri në 20.000.000 euro.

Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Përdorimi i shumës së huasë (20 milion euro), kushtet me të cilat vihet në dispozicion, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis KfW-së dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Premtimi i shumës së huasë do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies nuk përfundohen brenda nja afati deri në datën 31 dhjetor 2017.

Sipas marrëveshjes së datës 30.06.2015, KfW-ja do të rifinancojë kredinë e dhënë në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje me subvencione interesi nga fondet buxhetore me interes të ulët të ofruara nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë së politikës së zhvillimit. Kushtet dhe afatet e kredisë përputhen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të marrëveshjes për njohje si Ndihmë Zyrtare për Zhvillim. Mbi këtë bazë dhe me kusht që Republika Federale e Gjermanisë të japë një garanci për kredinë, KfW do të japë një kredi në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje kredie. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një kredi që nuk tejkalon një total prej 20,000,000 eurosh. Huamarrësi do ta kanalizojë plotësisht huanë te Agjencia Zbatuese e Projektit (KESH) në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje. Agjencia Zbatuese e Projektit do ta përdorë Kredinë ekskluzivisht për:

- Rehabilitimin e kanaleve të derdhjes në hidrocentralin e Vaut të Dejës;
- Implementimin e një Qendre Monitorimi dhe Dispeçerimi të digës;
- Shërbime konsulence,

program i cili është pjesë e Projektit të Përgjithshëm të Sigurisë së Digave.

Huamarrësi, Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e programit dhe furnizimet, mallrat, punimet dhe shërbimet që do të financohen nga huaja me anë të një marrëveshjeje të veçantë.

Taksat dhe tarifat e tjera publike që përbëjnë detyrim për huamarrësin ose Agjencinë Zbatuese të Projektit, si dhe tarifat doganore, nuk do të financohen nga kredia.

Huamarrësi do ta kanalizojë kredinë te Agjencia Zbatuese e Projektit sipas një marrëveshjeje të veçantë huadhënjeje me termat dhe kushtet përkatëse të huadhënies të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Përpara disbursimit të parë të kredisë, huamarrësi duhet t'i dërgojë KfW-së një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së huadhënies. Sapo të plotësohen të gjitha kushtet paraprake për disbursimin, KfW-ja do të disbursojë huanë në përputhje me progresin e programit dhe me kërkesë të Agjencisë Zbatuese të Projektit. Disbursimi do të bëhet në përputhje me skemën e disbursimit të përfshirë në këtë marrëveshje. KfW-ja do të bëjë disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtëmujor. Në masën që Agjencia Zbatuese e Projektit kërkon disbursimin e shumave më të ulëta brenda gjashtëmujorit, shumat e padisbursuara mund të kërkojnë në cilëndo nga periudhat e ardhshme gjashtëmujore. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të bëjë disbursime më të vogla se 200,000 euro. KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të bëjë disbursime pas 30 dhjetorit 2018. Ajo është e detyruar të bëjë disbursime sipas marrëveshjes vetëm nëse kushtet paraprake të

përcaktuara në këtë marrëveshje janë përmbushur në një mënyrë të kënaqshme për të, në formë dhe në përmbajtje.

Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme prej 0,25% në vit (Tarifa e Angazhimit) mbi shumat e padisbursuara të kredisë. Tarifa e angazhimit do të ngarkohet, nëse është e aplikueshme, me efekt prapaveprues për periudhën që fillon tre muaj pasi kjo marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe të ketë efekt dhe që zgjat deri në datën e disbursimit të plotë të kredisë ose, nëse është e aplikueshme, deri në datën e ndërprerjes përfundimtare të disbursimeve nga kredia.

Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë menaxhimi të pakthyeshme një herëshe prej 1% të shumës së deklaruar të kredisë (Tarifa e Menaxhimit). Tarifa e menaxhimit paguhet në datën më të hershme nga dy datat e mëposhtme: a) para disbursimit të parë; ose b) pasi të kenë kaluar tre muaj që nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ose pasi të ketë kaluar një muaj që nga hyrja në fuqi dhe efekti i kësaj marrëveshjeje. Tarifa e Menaxhimit duhet të paguhet sapo të nënshkruhet kjo marrëveshje, pavarësisht nëse kredia disbursohet plotësisht, vetëm pjesërisht ose asgjë.

Huamarrësi do ta shlyejë kredinë si më poshtë:

**Tabela nr.1**

<b>Kësti</b>	<b>Data</b>	<b>Vlera</b>
1	30 Qershor 2019	1,176,000,00 Euro
2	30 Dhjetor 2019	1,176,000,00 Euro
3	30 Qershor 2020	1,176,000,00 Euro
4	30 Dhjetor 2020	1,176,000,00 Euro
5	30 Qershor 2021	1,176,000,00 Euro
6	30 Dhjetor 2021	1,176,000,00 Euro
7	30 Qershor 2022	1,176,000,00 Euro
8	30 Dhjetor 2022	1,176,000,00 Euro
9	30 Qershor 2023	1,176,000,00 Euro
10	30 Dhjetor 2023	1,177,000,00 Euro
11	30 Qershor 2024	1,177,000,00 Euro
12	30 Dhjetor 2024	1,177,000,00 Euro
13	30 Qershor 2025	1,177,000,00 Euro
14	30 Dhjetor 2025	1,177,000,00 Euro
15	30 Qershor 2026	1,177,000,00 Euro
16	30 Dhjetor 2026	1,177,000,00 Euro
17	30 Qershor 2027	1,177,000,00 Euro

**Burimi i të dhënave KESH SHA**

Në “Marrëveshjen e Veçantë” me KfW përcaktohet se projekti ka të bëjë me rehabilitimin e derdhjeve të Hidrocentralit të Vaut të Dejës dhe implementimin e një Qendre dhe Sistemi Monitorimi për digën në Kaskadën e Drinit. Qëllimi i këtij projekti është të kontribuojë në rritjen e sigurisë së digës dhe mbrojtjen e popullsisë në këtë zonë si dhe sigurimi i HEC-eve në Kaskadën e Drinit dhe përmirësimi i efikasitetit të tyre. Kjo do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në mbrojtjen e klimës në Shqipëri.

Hartimi i projektit bazohet në studimin e fizibilitetit të vitit 2009 dhe raportet e hetimeve të mëtejshme në dispozicion të KfW-së, Huamarrësit dhe Agjencisë Zbatuese të Projektit gjatë vlerësimit lokal të projektit.

Nga kredia do të financohen aktivitetet e mëposhtme të projektit:

- Sistemi dhe Qendra e Monitorimit për Kaskadën e Drinit

- Rehabilitimi i derdhjeve të HEC-it të Vaut të Dejës
- Shërbimet konsulente për zbatimin e projektit

Gjithashtu kjo marrëveshje e veçantë përcakton se kostoja totale e parashikuar e projektit në bazë të vlerësimit të projektit është afërsisht 20 milion euro. Shuma e kredisë është deri në 20 milion euro.

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare do të jetë përgjegjëse për zbatimin e projektit dhe ka krijuar një Njësi të Menaxhimit të Projektit (PMU) për të koordinuar të gjitha aktivitetet e projektit.

Kushtet e pagesës do të jenë në përputhje me praktikën e zakonshme ndërkombëtare në industrinë përkatëse dhe do të parashikojnë që pagesat të varen nga ofrimi i furnizimeve dhe performanca e shërbimeve dhe të jenë në përputhje me ecurinë e projektit.

Palët do të bien dakord për penalitete kontraktuale në rast se kontraktorët nuk i kryejnë shërbimet brenda periudhës së rënë dakord për arsye për të cilat kontraktori është përgjegjës dhe nëse ky dështim çon në një vonesë në pranimin dhe vënien në funksion të projektit.

Me VKM Nr.405, datë 19.06.2019 është miratuar, në parim, Marrëveshja Ndryshuese e Marrëveshjes së Huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, SH.A., (Agjencia Zbatuese e Projektit), dhe KfW Frankfurt Am Main (KfW), për programin “Energjia Ujore dhe Siguria e Digave në Kaskadën e Drinit”, ratifikuar me Ligjin Nr. 85/2015. Sipas kësaj marrëveshjeje ndryshuese afati i fundit për kërkesën e disbursimit ndryshon si vijon: KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryej disbursime pas datës 31 maj 2021.

Sipas marrëveshjes ndryshuese, huamarrësi do ta paguajë huanë si më poshtë:

**Tabela nr.2**

Pagesa	Data	Vlera
1	30 qershor 2021	1,538,461.53 Euro
2	31 dhjetor 2021	1,538,461.53 Euro
3	30 qershor 2022	1,538,461.53 Euro
4	31 dhjetor 2022	1,538,461.53 Euro
5	30 qershor 2023	1,538,461.53 Euro
6	31 dhjetor 2023	1,538,461.53 Euro
7	30 qershor 2024	1,538,461.53 Euro
8	31 dhjetor 2024	1,538,461.53 Euro
9	30 qershor 2025	1,538,461.53 Euro
10	31 dhjetor 2025	1,538,461.53 Euro
11	30 qershor 2026	1,538,461.53 Euro
12	31 dhjetor 2026	1,538,461.53 Euro
13	30 qershor 2027	1,538,461.64 Euro

**Burimi i të dhënave KESH SHA**

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 19.06.2019 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndryshuese të Huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sha ...” me anën e të cilës janë miratuar:

Zgjatja e afatit të kryerjes së pagesave deri 31.05.2021.

Ndryshimin e emrit nga Ministria e Financave në Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Si dhe ndryshimin e skedulit të pagesave dhe kësteve.

Me shkesën datë 12.05.2021 të KfW-së është shtyrë afati i disbursimeve deri në datë 30.12.2021.

Me shkresën nr. 9628/1, datë 30.05.2022 “Dërgohet kopje origjinale të marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë” Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka dërguar KESH

sha marrëveshjen ndryshuese e cila parashikon zgjatjen e afateve të kredisë deri në 30.12.2023.

Me shkresën datë 19.01.2024 të KfW-së është shtyrë afati i disbursimeve deri në datë 31.03.2024 pa kosto shtesë.

## **2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.**

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit nr. 315/1, datë 12/03/2025 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Marrëveshjet e financimit të projektit.
2. Raportet e projektit
3. Dokumentacion i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në marrëveshje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Objektivi kryesor i projektit të “*Rehabilitimit të portave të shkarkimit dhe konstruksionit të strukturave të reja në HEC-in e Vaut të Dejës*”, (*Rehabilitation of Spillways and Construction of new Stoplogs at Vau i Dejes HPP, ViD*) dhe Projektit “*Qendra e Monitorimit dhe Dispečerisë së Digave për HEC-et e Kaskadës së Lumit Drin*”, (*Dam Monitoring and Dispatch Centre for Drin River Cascade Monitoring, DMDC*) janë rritja e sigurisë strukturore dhe operacionale të digave në Kaskadën e Drinit. Kjo përfshin reduktimin e rrezikut të kolapsit, përmirësimin e vëzhgimit dhe të reagimit operativ ndaj ngjarjeve emergjente.

### **Objektivat dhe Fushëveprimi i Projektit**

HEC-i i Vaut të Dejës, si hidrocentrali i fundit i kaskadës së lumit Drin, luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e ujit dhe përmbytjeve në Shqipëri dhe rrjedhimisht në mbrojtjen dhe sigurinë e popullsisë së Shqipërisë në rajonin verior. Prandaj, një nga objektivat kryesore të projektit ishte rehabilitimi i strukturave ekzistuese hidraulike të çelikut të derdhjes së Zadejës dhe Qyrfaqit në rezervuarin e Vaut të Dejës, për të siguruar funksionimin e sigurt dhe të besueshëm të këtyre strukturave për dekadat e ardhshme pas më shumë se 50 vjetësh funksionimi. Ndërsa strukturat hidraulike të çelikut janë nën rehabilitim, kapaciteti i përgjithshëm i portave të shkarkimit do të reduktohej. Prandaj, u përcaktua si kusht kryesor për projektimin dhe zbatimin e të gjitha punimeve të projektit pra rehabilitimin e portave të shkarkimit në një rend të njëpasnjëshëm, duke siguruar gjithmonë disponueshmërinë e 4 portave për shkarkimin nga përmbytjet në rast emergjence.

HEC-i i Vaut të Dejës furnizohet nga rezervuari i Vaut të Dejës. Hidrocentrali siguron një sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe për këtë arsye ndërprerjet ose kohët e prodhimit të reduktuar të hidrocentraleve po çojnë në sfida dhe kërcënime për KESH-in, si dhe për popullsinë e Shqipërisë. Për shkak të mungesës së një sistemi ndalimi në derdhjen e Qyrfaqit, nuk ishte e mundur të inspektoheshin dhe mirëmbaheshin plotësisht tre portat radiale të Qyrfaqit në të kaluarën, sepse ana e sipërme e portave radiale të derdhjes nuk ishte e arritshme pa ulur nivelin e ujit të rezervuarit. Si pasojë, një objektiv kryesor i projektit ishte instalimi i një sistemi të ri të përhershëm ndalimi në derdhjen e Qyrfaqit, duke lejuar inspektimin, riparimin ose rinovimin e portave radiale në nivelin e plotë të rezervuarit.

Projektimi dhe zbatimi i strukturës së re të ndalimit, dhe të gjitha punimet dhe masat paraprake, duhej të zbatoheshin pa ulur nivelin e rezervuarit për të shmangur ndikimin negativ në prodhimin e energjisë së hidrocentralit. Raporti i Përfundimit të Zbatimit Fusha e punimeve për rehabilitimin e derdhjes së Vau i Dejës të Kontraktorit përfshin projektimin e plotë të punimeve të rehabilitimit/zëvendësimit, prodhimin, çmontimin, para-montimin, testimin e pranimit siç renditet më poshtë:

### Kanali i Shkarkimit Zadeja

- rinovim dhe përforcim i plotë i bllokuesve ekzistues
- zëvendësim i një paneli bllokues të dëmtuar ekzistues
- furnizim me një tra të ri ngritës blloku
- rinovim i plotë i vinçit ekzistues monorail, përfshirë strukturën mbështetëse
- rinovim i plotë i dy portave radiale ekzistuese
- rinovim i plotë i pjesëve të fiksuara/të ngulitura të portave radiale dhe strukturës së bllokut
- rinovim i plotë i dy vinçave ekzistues të portave radiale
- përmirësim i pajisjeve ekzistuese elektrike, monitoruese dhe kontrolluese të portave radiale
- riparime betoni të mureve të shtyllave dhe punimeve civile në lidhje të drejtpërdrejtë me pjesët e ngulitura
- mbyllje e tubit ekzistues të kullimit, i cili kalon nëpër shtyllat e kanalit të shkarkimit.

### Struktura Hidraulike Çeliku - Derdhësi Qyrsaq

- të gjitha punimet e përkohshme të nevojshme për zbatimin e një sistemi të ri të përhershëm të ndalimit dhe rinovimin pasues të portave ekzistuese radiale
- një sistem i plotë i ri i përhershëm i ndalimit për të tre hapësirat e derdhjes, duke përdorur të njëjtin grup panelesh ndalimi
- një sistem i plotë i ri i trajtimit të ndalimit, duke përfshirë vinçin monorail, traun ngritës dhe stendat e magazinimit
- rinovim i plotë i tre portave ekzistuese radiale
- rinovim i plotë i pjesëve fikse/të ngulitura të portave radiale
- rinovim i plotë i tre vinçave ekzistues të portave radiale
- rinovim i plotë i sistemit të portave me kapak (porta me kapak me mentesha në majë të portave radiale), duke përfshirë zëvendësimin e plotë të sistemit hidraulik përkatës (servomotorë, njësi presioni hidraulik, tubacione, etj.)
- përmirësim i pajisjeve ekzistuese elektrike, monitoruese dhe kontrolluese të portave radiale
- riparime betoni të kreshtës së mureve të skelave dhe punimeve civile në lidhje të drejtpërdrejtë me pjesët e ngulitura
- modifikim i urës për të mundësuar instalimin e strukturës së re të përhershme të ndalimit dhe sistemit të trajtimit të ndalimit
- riparim betoni i zona e dëmtuar e trarit të vulosjes së portës radiale të derdhjes nr. 2.

### Objektivat dhe komponentët e projektit DMDC

Projekti "Qendra e Monitorimit dhe Dispeçerisë së Digave për HEC-et e Kaskadës së Lumit Drin" (DMDC) bazohet në një bashkëpunim financiar me Bankën Gjermane të Zhvillimit KfW, me fokus në energjinë hidroelektrike dhe sigurinë e digave në kaskadën e lumit Drin, i cili hyri në fuqi më 7 gusht 2015. Ky financim përfshin zbatimin e një DMDC për HEC-et e kaskadës së lumit Drin. Kaskada e Drinit ndodhet në pjesën e poshtme të pellgut të Drinit. Tre digat që operohen nga KESH (Fierza, Komani dhe Vau i Dejës) mbulojnë një rënie prej 263 m2 me një kapacitet të instaluar total prej 1350 MW. Objektivi i përgjithshëm i DMDC-së së re do të jetë të sigurojë funksionimin dhe monitorimin e Kaskadës së Lumit Drin, duke përfshirë digat dhe HEC-et, përveç tre Dhomave lokale të Kontrollit (një në secilin HEC) gjithashtu nga Qendra e re e Monitorimit dhe Dispeçerisë së Digave në selinë qendrore të KESH-it në Tiranë. F, u caktua për të kryer studimin e fizibilitetit për DMDC-në, dhe Raporti i Fizibilitetit, Rev. 1, u përfundua nga F, në qershor 2017. Sipas Termave të Referencës për DMDC-në, ky Raport i Fizibilitetit shërbeu si bazë për përgatitjen e një projekti paraprak dhe përgatitjen e dokumenteve të tenderimit. Megjithatë, që nga përfundimi i këtij Raporti, disa projekte janë përfunduar, dhe të tjera ishin ende në vazhdim. Në veçanti, projekti që synonte rehabilitimin e instrumenteve të digave dhe rrëshqitjeve të dheut, i financuar nga SECO, me A. si Konsulent,

dhe S. dhe S. P. si furnizues të instrumenteve, është përfunduar. Ndryshimet e identifikuar në lidhje me Raportin e Fizibilitetit të F, u renditën dhe u përshkruan në Raportin Fillestar të Konsulentit të Zbatimit.

### **Analiza e përputhshmërisë së realizimit**

Projekti ViD:

- Të gjitha ndërhyrjet në digën anësore dhe shkarkuesin u realizuan sipas standardeve teknike.
- Në shqyrtimin e kryerjes së zbatimit u konstatua se koherenca aktuale e zbatimit dhe datat e përfundimit ndryshojnë ndjeshëm nga planifikimi fillestar i projektit. Pothuajse të gjitha detyrat dhe aktivitetet kryesore u vonuan ndjeshëm me të paktën një vit dhe përfundimi i përgjithshëm i projektit u vonua me 662 ditë, ekuivalent me pothuajse 2 vite kalendarike. Më poshtë, arsyeja kryesore për këto vonesa ishte pasoja e pandemisë COVID-19, kur filluan kufizimet në mbarë botën, duke përfshirë udhëtimin, transportin, etj. duke e vonuar ndjeshëm projektin gjatë 2 viteve të para të zbatimit.

Projekti DMDC:

- Qendrat e komandimit dhe infrastruktura SCADA janë instaluar dhe funksionale
- Kontrolli i largët mbi tre HEC-et e kaskadës është aktiv
- Integrimet me OST mbetën të pjesshme për shkak të kushteve jashtë kontrollit të KESH

Zhvillimi i projektit dhe vonesat

Të dy projektet u hasën me ndryshime të shpeshta në planin e punimeve dhe vonesa të konsiderueshme për shkak të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të bashkërenditur si më poshtë:

- Në projektin ViD, vonesat vinin nga proceset e prokurimit dhe mungesa e fondeve për disa komponentë plotësues. ViD kaloi nga 24 muaj në mbi 48 muaj.
- DMDC u shty për shkak të pandemisë COVID-19, problemeve me kontraktimin e furnitorëve dhe koordinimit me OST. DMDC kaloi nga 30 muaj në 73 muaj.

Si përfundim

-Projektet ViD dhe DMDC në përgjithësi janë zbatuar në përputhje me objektivat pavarësisht sfidave të afateve dhe bashkërendimit institucional por jo në kohë sipas marrëveshjes. Ndërhyrjet kanë përmirësuar infrastrukturën dhe sigurinë operationale të Kaskadës së Drinit.

### **2.3 Mbi menaxhimin financiar të programit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.**

Mbi auditimin e ushtruar në KESH për projektin “Fuqia Ujore dhe siguria e digave në Kaskadën e Drinit”, në zbatim të pikës 1 të Programit të Auditimit nr. 315/1, datë 12/03/2025 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Marrëveshjet e financimit të projektit.
2. Raportet e projektit
3. Disbursimet e kryera
4. Dokumentacion i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të parashikuar në marrëveshje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Për realizimin e projektit “Fuqia Ujore dhe siguria e digave në Kaskadën e Drinit” është marrë huaja në vlerën 20,000,000 euro nga KfW, e cila është ratifikuar në parlament me Ligjin nr. 87/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2009, për projektin “Energjia ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit”.

Banka ka rënë dakord që t’i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të parashikuara apo të referuara në këtë marrëveshje, shumën prej euro 20,000,000.

Huamarrësi do ta kanalizojë plotësisht Huanë te Agjencia Ekzekutuese e Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Nenin 2 të Marrëveshjes. Agjencia Ekzekutuese e Projektit do ta përdorë Huanë ekskluzivisht për:

- a) Rehabilitimin e portave të shkarkimit së hidrocentralit të Vaut të Dejës,
- b) Ngritjen e një Qendre Monitorimi,
- c) Shërbime Konsulence.

Pika 3 e Marrëveshjes “Disbursimet”

Referuar pikës 3.2 afati i fundit i kryerjeve të pagesave nga kredia është 30.12.2018.

Pika 4 “Tarifat”

4.1 Tarifa e angazhimit. Huamarrësi do të paguaj një tarifë e parimbursueshme prej 0.25% e shumës së padisbursuar nga Huaja.

Tarifa e angazhimit paguhet dy herë në vit 30 qershor dhe 30 dhjetor, duke filluar nga 30 qershori i 2015 por jo më parë se hyrja në fuqi e marrëveshjes.

4.2 Tarifa e manaxhimit. Huamarrësi do të paguaj KfW një shumë të parimbursueshme një herë sa 1% e Huasë.

Tarifa e manaxhimit paguhet në datën më të hershmen midis përpara disbursimit të parë ose pas tre muaj të nënshkrimit të marrëveshjes.

Pika 6 “Ripagimi dhe parapagimi”:

6.1 Skeduli i ripagimit. Huamarrësi do të ripaguaj si më poshtë:

**Tabela nr.3**

Nr.	Data		Shuma
1	30 qershor	2019	1.176,000 euro
2	30 dhjetor	2019	1.176,000 euro
3	30 qershor	2020	1.176,000 euro
4	30 dhjetor	2020	1.176,000 euro
5	30 qershor	2021	1.176,000 euro
6	30 dhjetor	2021	1.176,000 euro
7	30 qershor	2022	1.176,000 euro
8	30 dhjetor	2022	1.176,000 euro
9	30 qershor	2023	1.176,000 euro
10	30 dhjetor	2023	1.176,000 euro
11	30 qershor	2024	1.176,000 euro
12	30 dhjetor	2024	1.176,000 euro
13	30 qershor	2025	1.176,000 euro
14	30 dhjetor	2025	1.176,000 euro
15	30 qershor	2026	1.176,000 euro
16	30 dhjetor	2026	1.176,000 euro
17	30 qershor	2027	1.176,000 euro

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

### Sipas Aneksit nr. 1

Pas çdo periudhe disbursimi, Huamarrësi mund të disbursojë deri në nivelin i cili nuk kalon shumën kumulative të disbursimit, konkretisht:

**Tabela nr.4** Në euro

Nr.	Data efektive e fundit të periudhës	Maksimumi i shumës së disbursuar deri në fund të periudhës (kumulative)
1	30.06.2015	0.00
2	30.12.2015	3,000,000.00
3	30.06.2016	6,000,000.00
4	30.12.2016	10,000,000.00
5	30.06.2017	14,000,000.00
6	30.12.2017	17,000,000.00
7	30.06.2018	19,000,000.00
8	30.12.2018	20,000,000.00

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

### Ndryshimet e marrëveshjes:

Me Vendimin e KM nr. 405, datë 19.06.2019 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndryshuese të Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe Koprорrata Elektroenergjitike Shqiptare sha ...” me anën e të cilës janë miratuar:

Zgjatja e afatit të kryerjes së pagesave deri 31.05.2021.

Ndryshimin e emrit nga Ministria e Financave në Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Si dhe ndryshimin e skedulit të pagesave dhe kështet si më poshtë:

**Tabela nr.5**

Nr.	Data	Vlera
1	30 qershor 2021	1,538,461.53 euro
2	31 dhjetor 2021	1,538,461.53 euro
3	30 qershor 2022	1,538,461.53 euro
4	31 dhjetor 2022	1,538,461.53 euro
5	30 qershor 2023	1,538,461.53 euro
6	31 dhjetor 2023	1,538,461.53 euro
7	30 qershor 2024	1,538,461.53 euro
8	31 dhjetor 2024	1,538,461.53 euro
9	30 qershor 2025	1,538,461.53 euro
10	31 dhjetor 2025	1,538,461.53 euro
11	30 qershor 2026	1,538,461.53 euro
12	31 dhjetor 2026	1,538,461.53 euro
13	30 qershor 2027	1,538,461.53 euro

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

Nga auditimi rezulton se aprovimi i zgjatjes së përdorimit të kredisë ka ardhur pas 6 muajsh si dhe shuma e disbursuar ka qenë 36,930 euro deri në afatin fillestar të mbarimit të kredisë.

Me shkresën datë 12.05.2021 të KfW është shtyrë afati i disbursimeve deri në datë 30.12.2021.

Me shkresën nr. 9628/1, datë 30.05.2022 “Dërgohet kopje origjinale të marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huasë” MFE i ka dërguar KESH sha marrëveshjen ndryshuese e cila parashikon zgjatjen e afateve të kredisë deri në 30.12.2023. MFE dhe KESH Sha ka paguar kosto refinancimi për zgjatjen e përdorimit të kredisë vlerën 372,225 euro.

Nëpërmjet një dakordësimi paraprak deri në 50% e shumës është marrë përsipër nga KfW.

Me emailin e datës 13.06.2022 KfW ka përcjell shumën për tu paguar prej 48,103 euro dhe kjo

shumë është paguar vlera nga KESH sha datë 27.06.2022. Rezulton se për shkak të tejzgjatjes së zbatimit të projektit KESH sha është ngarkuar me kosto shtesë.

Me shkesën datë 19.01.2024 të KfW është shtyrë afati i disbursimeve deri në datë 31.03.2024 pa kosto shtesë.

Ecuria e disbursimeve në vite:

**Tabela nr.6**

Viti	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Totali
Shuma	34,930	69,860	3,432,631.5	2,607,291.17	2,966,767.22	7,849,575.13	2,970,295.99	19,931,351.01

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

Nga auditimi rezulton se projekti është zgjatur për mbi 6 vite dhe ka 4 shtyrje të afatit të disbursimeve dhe në të gjitha rastet aprovimi i shtyrjes së afatit ka ardhur pas mbarimit të afatit të disbursimit të huasë, duke e ekspozuar projektin ndaj mos vijimit dhe përmbushjes së tij.

Realizimi i komponentëve të projektit:

**Tabela nr.7**

Kreditë	Vlera totale e kontratës	Disbursuar deri më 31.03.2024	Në euro	
			Pa disbursuar	% e realizimit të disbursimit
<b>Kredia KfW 26946 / BMZ 2009 66 531</b>	<b>20,000,000.00</b>	<b>19,931,351.01</b>	<b>68,648.99</b>	<b>99.66%</b>
<b>1.Reabilitimi i portave të shkakimit (të mira, punë dhe shërbime)</b>	<b>14,000,000.00</b>	<b>16,527,249.61</b>	<b>-2,527,249.61</b>	
1.1 Reabilitimi i portave të shkakimit (të mira, punë dhe shërbime) VAU DEJES HPP	16,527,249.61	16,527,249.61	-	100.00%
<b>2 .Implementimi i qendrës dispecer (të mira, punë dhe shërbime)</b>	<b>3,000,000.00</b>	<b>1,895,510.24</b>	<b>1,104,489.76</b>	
2.1 Implementimi i qendrës dispecer - J. A. O.	511,258.00	511,258.00	-	100.00%
2.2 Prokurimi i Qendrës së monitorimit – K.	1,384,252.24	1,384,252.24	-	100.00%
<b>3.Shërbimi i konsulencës</b>	<b>1,700,000.00</b>	<b>1,508,591.16</b>	<b>191,408.84</b>	
3.1 Shërbimi i konsulencës për implementimit - F. No. 2009 66531 Loan 26946	1,526,204.00	1,508,591.16	17,612.84	98.85%
<b>4. Kontigjenca</b>	<b>1,300,000.00</b>	<b>-</b>	<b>1,300,000.00</b>	

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

### Pagesa e TVSH:

Bazuar në marrëveshje TVSH e projektit do të trajtohet si kosto lokale dhe do të rimbursohet nga KESH Sha:

#### JV A. TVSH sipas viteve

**Tabela nr.8**

	Nr. Faturës	Vlera pa TVSH	TVSH	Vlera Totale
<b>Viti 2019</b>	46/12.12.2019	4,898,400.00	979,680.00	5,878,080.00
<b>Viti 2021</b>	4/30.04.2021	8,623,300.00	1,724,660.00	10,347,960.00
	4/2021/27.12.2021	15,650,700.00	3,130,140.00	18,780,840.00

<b>Viti 2023</b>	1/2023/15.02.2023	6,088,450.00	1,217,690.00	7,306,140.00
	2/2023/29.06.2023	8,934,138.00	1,786,827.60	10,720,965.60
	3/2023/30.10.2023	9,309,594.42	1,861,918.88	11,171,513.30
	4/2023/21.11.2023	4,864,077.12	972,815.42	5,836,892.54

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

**F, TVSH sipas viteve**

**Tabela nr.9**

	<b>Nr Faturës</b>	<b>Vlera pa TVSH</b>	<b>TVSH</b>	<b>Vlera Totale</b>
<b>Viti 2018</b>	68/16.01.2018	5,114,562.10	1,022,912.42	6,137,474.52
	75/04.05.2018	-297,882.00	-59,576.40	-357,458.40
<b>Viti 2019</b>	13/21.08.2019	8,465,635.00	1,693,127.00	10,158,762.00
	17/21.10.2019	6,474,450.15	1,294,890.03	7,769,340.18
<b>Viti 2020</b>	22/30.06.2020	11,943,789.55	2,388,757.91	14,332,547.46
	25/28.09.2020	11,889,036.78	2,377,807.36	14,266,844.13
	39/15.12.2020	10,675,838.70	2,135,167.74	12,811,006.44
<b>Viti 2021</b>	1/2021/09.03.2021	10,679,293.03	2,135,858.61	12,815,151.64
	4/2021/25.03.2021	488,848.12	97,769.62	586,617.74
	13/2021/26.04.2021	135,874.69	27,174.94	163,049.63
	19/2021/01.06.2021	10,622,299.75	2,124,459.95	12,746,759.70
	30/2021/12.07.2021	690,801.90	138,160.38	828,962.28
	36/2021/02.09.2021	10,524,720.70	2,104,944.14	12,629,664.84
	45/2021/28.09.2021	1,215,200.00	243,040.00	1,458,240.00
	49/2021/15.10.2021	315,657.79	63,131.56	378,789.35
	51/2021/04.12.2021	10,461,682.91	2,092,336.58	12,554,019.49
<b>Viti 2022</b>	1/2022/05.01.2022	462,498.18	92,499.64	554,997.81
	5/2022/10.03.2022	10,683,610.48	2,136,722.10	12,820,332.58
	6/2022/11.03.2022	350,345.35	70,069.07	420,414.42
	11/2022/03.06.2022	10,387,419.21	2,077,483.84	12,464,903.05
	12/2022/03.06.2022	360,836.32	72,167.26	433,003.58
	30/2022/26.10.2022	8,186,862.01	1,637,372.40	9,824,234.41
	36/2022/26.10.2022	215,193.80	43,038.76	258,232.55
	40/2022/09.12.2022	8,039,044.63	1,607,808.93	9,646,853.55
	41/2022/09.12.2022	577,518.00	115,503.60	693,021.60
<b>Viti 2023</b>	2/2023/17.03.2023	7,957,849.17	1,591,569.83	9,549,419.00
	3/2023/17.03.2023	176,665.19	35,333.04	211,998.23
	12/2023/26.06.2023	7,428,343.72	1,485,668.74	8,914,012.47
	13/2023/26.06.2023	357,091.86	71,418.37	428,510.23
	19/2023/22.09.2023	7,381,843.99	1,476,368.80	8,858,212.78
	20/2023/22.09.2023	497,062.76	99,412.55	596,475.31
	26/2023/19.12.2023	7,152,834.34	1,430,566.87	8,583,401.21
	27/2023/19.12.2023	167,154.80	33,430.96	200,585.76
<b>Viti 2024</b>	11/2024/11.03.2024	6,310,239.12	1,262,047.82	7,572,286.94
	12/2024/11.03.2024	191,503.16	38,300.63	229,803.79
	13/2024/11.03.2024	2,577,998.98	515,599.80	3,093,598.78

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

Nga auditimi konstatohet se KESH Sha ka kryer rimbursimin e TVSH bazuar në faturën me TVSH pa hartuar dhe zbatuar filtra kontrolli nëse realisht kontaktori e ka kryer pagesën e TVSH.

### **Pagesat e kryer nga Ministria e Financave:**

Referuar të dhënave të marra nga Ministria e Financave me emailin e datës 29.04.2024 ku janë pasqyruar të gjitha pagesat e kryera nga MF për këtë projekt:

**Tabela nr.10**

	Principal	Interes	Komisione
	EUR	EUR	EUR
<b>2015</b>	-	-	212,500.00
<b>2016</b>	-	-	50,000.00
<b>2017</b>	-	-	50,000.00
<b>2018</b>	-	353.67	49,941.06
<b>2019</b>	-	523.96	49,912.68
<b>2020</b>	-	36,891.12	43,851.49
<b>2021</b>	3,076,923.06	60,496.99	37,994.10
<b>2022</b>	3,076,923.06	47,464.75	80,576.83
<b>2023</b>	3,076,923.06	81,379.97	19,128.97
<b>2024</b>	3,076,923.06	143,437.65	1,093.71
<b>Totali</b>	12,307,692.24	370,548.11	594,998.84

*Burimi i të dhënave: KESH SHA*

Nga auditimi rezulton se për shkak të zgjatjes së projektit dhe mos disbursimit në kohë të fondeve të vendosura në dispozicion MF ka paguar ndaj KfW vlerën prej 382,498.84 euro, e cila është kosto shtesë për MF dhe KESH sha.

### **Marrëveshja e nënhuasë:**

Në bazë të marrëveshjes së huasë është lidhur Marrëveshje e Nënhuasë nr. 7551/2, datë 06.01.2016 midis MF dhe KESH Sha ku detyrimet financiare e parashikuara në marrëveshje i kanë kaluar KESH SHA ku janë parashikuar edhe detyrimet përkatëse.

Nga auditimi rezulton se KESH SHA nuk ka kryer asnjë pagesë ndaj MF në lidhje me detyrimet e kësaj kredie. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Marrëveshjen e Nënhuasë si dhe kanë ngarkuar buxhetin e shtetit me kosto ekstra dhe detyrime të cilat duhet ti mbulojë KESH sha.

Referuar pikës 3.4 “Në rast mos shlyerje të detyrimit MF rezervon të drejtën e konfiskimit të të ardhurave nga shitja e energjisë” pra mos pagesa e detyrimeve të kredisë e ekspozon KESH sha ndaj pasojave financiare.

Gjithashtu konstatohet se Marrëveshja e Nënhuasë nuk ka ndryshua dhe reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur në Marrëveshjen e Huasë për sa i përket riskedulimit të pagesës së kësteve dhe afatet.

### **2.4 Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të prokurimit të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacioni shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.**

Në zbatim të pikës 4 dhe 5 të Programit të Auditimit nr. 315/1, datë 12.03.2025, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni i procedurës së prokurimit  
-Kontrata e konsulentit dhe Adendumet e saj  
-Raportet e konsulentit  
-Pagesat e kryera, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

**-Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Konsulenti i Implementimit të Rehabilitimit të Portave të Shkarkimit të HEC Vau i Dejës”.**

Njoftimi i para kualifikimit për prokurimin “Konsulenti i Implementimit të Rehabilitimit të Portave të Shkarkimit të HEC Vau i Dejës” është botuar në website “gtai.de” në datën 19.08.2016, në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW (pika 2.5.1 “Publikimi i njoftimit për tender”).

-Është publikuar në gazetën Panorama më 19.08.2016.

-Është publikuar në gazetën Shqiptarja.com më 19.08.2016.

Afati për dorëzimin e aplikimeve:

Afati për dorëzimin e aplikimeve ka qenë data 19.09.2016.

Afati i vendosur është në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane Për Zhvillim KfW, pika 2.4.10 Afatet e dorëzimit, (1) dorëzimi i aplikimeve, ku citohet se afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 30 dite kalendarike.

Hartimi i dokumentacionit parakualifikues:

KfW ka aprovuar dokumentet e parakualifikimit me shkresën e datës 11.08.2016 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me dokumentet e paraku alifikimit”.

Komisioni i vlerësimit të procedurës së prokurimit:

Me urdhër nr.40, datë 19.09.2016 ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit me objekt: “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për konsulencë teknike për zbatimin e punimeve rehabilituese të portave të shkarkimit dhe remontit të Vau i Dejës”, me përbërje si më poshtë:

- I. B. – Kryetar
- F.B.– Anëtar
- A.G.– Anëtar
- E.Sh.– Anëtar
- B.K.- Anëtar

Me urdhër nr.29, datë 30.05.2017 ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit me objekt: “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për konsulencë teknike për zbatimin e punimeve rehabilituese të portave të shkarkimit dhe remontit të Vau i Dejës”, me përbërje si më poshtë:

- I. B. – Kryetar
- F.B.– Anëtar
- A.G.– Anëtar
- T.H. – Anëtar
- B.K. - Anëtar

### Letra qarkulluese

Gjate periudhës nga publikimi i njoftimit për parakualifikim dhe deri në dorëzim të aplikimeve nga operatorët ekonomike të ndryshëm të interesuar janë dorëzuar kërkesa për sqarime dhe ju është përgjigjur me letrat sqaruese datë 02.09.2016 dhe datë 09.12.2016.

### **Faza e parë**

#### Vlerësimi paraprak

• Referuar dokumentacionit të administruar (hard copy) nga grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se dokumentacioni, si në formatin hard copy ashtu edhe në formatin soft copy, është administruar nga PMU. Aplikimet e dorëzuara janë hapur në datën 19.09.2016 nga pesë anëtarë të komisionit të përcaktuar në urdhrin nr. 40, datë 19.09.2016, të titullarit të KESH Sha, konkretisht nga I. B., F.B., A.G., E. Sh. dhe B.K..

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit referues u konstatua se ofertat nuk janë dorëzuar në protokollin e insitucionit ku të jetë e dokumentuar data e dorëzimit të ofertës në KESH SHA.

Referuar shkresës së mbajtur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit institucional (pa datë dhe pa nr. protokolli), kanë shprehur interes 12 shoqëri konsulente si më poshtë:

1. F, GmbH & Co. KG
2. St. Ing. G. P.
3. A. of HPC AG, H. & V. G.
4. S. GmbH
5. C C.
6. A. E. & E.
7. L. I.GmbH
8. M. Spa
9. M. AS
10. P. I. GmbH
11. K.
12. G. GmbH & Ko

#### **Nga auditimi konstatohet se:**

- Për shkak të mungesës së informacionit mbi procesin e protokollimit të dokumentacionit parakualifikues të dorëzuar nga shoqëritë konsulente, grupi i auditimit të KLSH kërkoi informacion pranë protokollit të KESH SHA.
- Zyra e protokollit pranë KESH nuk ka mbajtur procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit parakualifikues tek NJKP.

#### Vlerësimi i Komisionit për Fazën Parakualifikuese

12 (dymbëdhjetë) shoqëritë i kanë dorëzuar aplikimet përpara skadimit të afatit të dorëzimit tek PMU. Afati për dorëzimin e aplikimeve, është përcaktuar se dorëzimi brenda afatit të përcaktuar të dorëzimit tek KESH sha do të merret në konsideratë.

Në vijim vlerësimi i aplikimeve është kryer për të 12 (dymbëdhjetë) shoqëritë, si vijon:

1. Vlerësimi i përputhshmërisë administrative

Të gjithë aplikantët kanë plotësuar këtë kriter dhe kanë dorëzuar dokumentet e kërkuara në dokumentet e parakualifikimit si vijon:

- a) Plotësia e Aplikimit
- b) Evidencë për burimet Financiare
- c) Evidencë për eksperiencën të ngjashme

Në përfundim, janë kualifikuar për të vijuar me vlerësimin teknik dhe financiar 5 shoqëri konsulente:

1. F. GmbH & C. K
2. S GmbH
3. A. E. & E.
4. L. I. GmbH
5. G. GmbH & Ko

Vlerësimi për Pikëzimin

**Referuar dokumentit të parakualifikimit, Seksioni I - Parashikime të Përgjithshme, pika 3 Dorëzimi i aplikimeve, nënpika 4.2.4 Punëdhënësi do të refuzojë një aplikim nëse; (b) Aplikanti është vlerësuar me më pak se 70 pikë.**

**Referuar këtij kushti janë vlerësuar me mbi 70 pikë aplikimet si vijon:**

- |                     |            |
|---------------------|------------|
| 1. F, GmbH & Co. KG | 82.18 pikë |
| 2. S. GmbH          | 84.52 pikë |
| 3. A. E.& E.        | 78.80 pikë |
| 4. L. I. GmbH       | 72.34 pikë |
| 5. Ga. GmbH & Ko    | 70.55 pikë |

Jane vlerësuar me më pak se 70 pikë aplikimet si vijon:

- |                |            |
|----------------|------------|
| 1. St. Ing. G. | 41.08 pikë |
| 2. A.          | 69.45 pikë |
| 3. iC C.       | 62.65 pikë |
| 4. M Spa       | 69.40 pikë |
| 5. M AS        | 68.99 pikë |
| 6. P I GmbH    | 45.33 pikë |
| 7. K           | 33.05 pikë |

KfW ka aprovuar vlerësimin e parakualifikimit me shkresën datë 17.03.2017 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit të Parakualifikimit”.

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit, me email datë 20.03.2017 ka njoftuar të 5 (pesë) aplikantët e mësipërm të suksesshëm mbi rezultatet e vlerësimit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me email datë 20.03.2017 janë njoftuar aplikantët e pa-suksesshëm mbi rezultatet e vlerësimit si dhe në bashkëpunim me PCU dhe KfW kanë përgatitur dokumentet e tenderit, të cilat KfW i ka aprovuar me shkresën datë 09.11.2016 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Dokumentet e Tenderit”.

Në vijim Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me PCU, me email datë 20.03.2017 i ka dërguar të 5 (pesë) aplikantëve të parakualifikuar ftesën për ofertë së bashku me setin e dokumenteve të tenderit, ku është përcaktuar edhe afati për dorëzimin e ofertave në datën 08.05.2017, duke plotësuar kushtin për afat të dorëzimit prej minimalisht 45 ditë kalendarike, sipas udhëzuesve të prokurimit të KfW pika 2.4.10 Afatet e dorëzimit, (2) dorëzimi i ofertave, ku citohet se “afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 45 ditë kalendarike”.

**Faza e dytë e vlerësimit**

Pas njoftimit të tenderit, PMU ka ftuar 5 shoqëritë e parakualifikuara, të cilat ishin vlerësuar me më shumë se 70 pikë, për të dorëzuar ofertat e tyre teknike dhe financiare, të ndara nga njëra-tjetra.

**Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, konstatohet se ofertat e operatorëve nuk janë dorëzuar në protokollin e institucionit si dhe nuk dokumentohet koha e dorëzimit në KESH SHA.**

1. F. GmbH & Co. KG
2. S GmbH
3. L I GmbH
4. G GmbH & Ko

**Nga auditimi konstatohet se:**

Ofertat e paraqitura nga kompanitë e kualifikuara nuk janë dorëzuar në protokollin e institucionit.

Vlerësim i ofertave teknike:

Ofertat janë dorëzuar brenda afatit vetëm nga 4 (katër) aplikantët e parakualifikuar.

PMU ka marrë vetëm 4 oferta në dorëzim përpara afatit të parashikuar të dorëzimit, datë 12.10.2017, ora 08:30 ofertat e konsulentëve F, GmbH & Co. KG, S. GmbH, L. I. GmbH, G. GmbH & Ko.

Kriteret e Vlerësimit

Metoda e vlerësimit e aplikuar referuar udhëzuesve të prokurimit të KfW është “përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto (QCBS)”.

Gjatë fazës së vlerësimit të propozimeve teknike aplikantët duhet të vlerësohen me minimalisht 75 pikë për të vazhduar më tej me hapjen e ofertave financiare.

Vlerësimi Teknik

Vlerësimi bazohet në vlerësimin e secilit kriter sipas dokumenteve të tenderit. Detajet e vlerësimit për secilin aplikant jepen si vijon:

- F. GmbH & Co. KG

Koncepti dhe Metodologjia 22.26 pikë nga maksimumi 40.00 pikë.

Kualifikimet e Stafit të propozuar 53.96 pikë nga maksimumi 60.00 pikë.

- G. GmbH & Ko

Koncepti dhe Metodologjia 26.88 pike nga maksimumi 40.00 pikë.

Kualifikimet e Stafit të propozuar 35.51 pikë nga maksimumi 60.00 pikë.

- L. I GmbH

Koncepti dhe Metodologjia 32.25 pike nga maksimumi 40.00 pikë.

Kualifikimet e Stafit të propozuar 51.82 pike nga maksimumi 60.00 pikë.

- S. GmbH

Koncepti dhe Metodologjia 32.50 pike nga maksimumi 40.00 pike.

Kualifikimet e Stafit të propozuar 45.01 pike nga maksimumi 60.00 pikë.

Rezultatet e vlerësimit teknik

- |                        |            |
|------------------------|------------|
| 1. F, GmbH & Co. KG me | 76.21 pikë |
| 2. G. GmbH & Ko me     | 62.39 pikë |
| 3. L. I GmbH me        | 84.07 pikë |
| 4. S. GmbH me          | 79.64 pikë |

KfW ka aprovuar vlerësimin e ofertave teknike me shkresën datë 12.09.2017 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit Teknik”.

### Vlerësimi i Propozimeve Financiare

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit teknik, në datën 12.09.2017, nga PMU në datë 14.09.2017 janë hapur ofertat financiare të aplikantëve që u vlerësuan me më shumë se 75 pikë gjatë vlerësimit të propozimeve teknike, nga ku rezultojnë si vijon:

- Oferta totale financiare e ofruar nga JV L. Int. GE/Sprint GE është 758,878.00 euro.
- Oferta totale financiare e ofruar nga F. GE është 372,700.00 euro.
- Oferta totale financiare e ofruar nga JV S. GE/S. CZ/ S. SE/ S. NO është 487,277.8 euro.

### Vlerësimi i kombinuar teknik dhe financiar:

Formula për vlerësimin e kombinuar teknik dhe financiar, ku 70% i takon vlerësimit teknik dhe 30% vlerësimit financiar, është:  $S=(T*0.7) + (F*0.3)$

Ku:

- S është rezultati përfundimtar i ofertuesit.
- T është rezultati i vlerësimit teknik (pikët e marra).
- F është rezultati i vlerësimit financiar (i konvertuar në pikë).

Vlerësimi financiar llogaritet sipas formulës:

$$F = \left( \frac{P_{min}}{P} \right) * 100$$

Ku:

- $P_{min}$  është çmimi më i ulët i ofertuar.
- $P$  është çmimi i ofertuesit që po vlerësohet.

### Rezultatet e Vlerësimit të Kombinuar

Nga auditimi konstatohet se vlerësimi i kombinuar për operatorët ekonomikë është si më poshtë:

- Vlerësimi i kombinuar për aplikantin “F, GmbH & Co. KG” është 93,46 pikë.
- Vlerësimi i kombinuar për aplikantin “S. GmbH Dahlem” është 89,26 pikë.
- Vlerësimi i kombinuar për aplikantin “L. International GmbH” është 84,73 pikë.

Bazuar në këto rezultate është rekomanduar për fitues aplikanti i renditur i pari me pikë që është aplikanti “F,” me ofertë 372,700.00 euro.

### Hartimi i Kontratës së Konsulentit

Në vijim Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me PMU dhe KfW kanë përgatitur dokumentin e kontratës së shërbimeve të konsulencës, të cilën KfW e ka aprovuar me shkresën datë 03.11.2017 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Draft Kontratën”.

Pas aprovimit të raportit të Dokumentit të Kontratës, është lidhur kontrata midis KESH SHA dhe F, datë 22.11.2017.

### **-Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Zbatimin e Punimeve Rehabilituese të Portave të Shkarkimit dhe Remontit të HEC Vau i Dejës”.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Njoftimi i parakualifikimit për prokurimin “Implementimi i Rehabilitimit të Portave të Shkarkimit të HEC Vau i Dejës” është botuar në website “gtai.de” në datën 02.05.2018, në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW (pika 2.5.1 “Publikimi i njoftimit për tender”).

Është publikuar në dgMarket më 03.05.2018.

Është publikuar në gazetën Panorama më 03.05.2018.

Afati për dorëzimin e aplikimeve:

Afati për dorëzimin e aplikimeve ka qenë data 04.06.2018.

Afati i vendosur është në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane Për Zhvillim KfW, pika 2.4.10 Afatet e dorëzimit, (1) dorëzimi i aplikimeve, ku citohet se afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 30 dite kalendarike.

Hartimi i dokumentacionit parakualifikues:

KfW ka aprovuar dokumentet e parakualifikimit me shkresën e datës 06.11.2018 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me dokumentet e parakualifikimit”.

Komisioni i vlerësimit të procedurës së prokurimit:

Me urdhër nr.38, datë 31.05.2017 ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit me objekt: “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për zbatimin e punimeve reabilituese të portave të shkarkimit dhe remontit të Vau i Dejës”, me përbërje si më poshtë:

- E.B. – Kryetar
- F.B.– Anëtar
- B.K.– Anëtar
- A.G.– Anëtar
- Z.Sh. - Anëtar

Letra qarkulluese

Gjate periudhës nga publikimi i njoftimit për parakualifikim dhe deri në dorëzim të aplikimeve nga operatorët ekonomike të ndryshëm të interesuar janë dorëzuar kërkesa për sqarime dhe ju është përgjigjur.

**Faza e parë**

Vlerësimi paraprak

Referuar dokumentacionit të administruar (hard copy) nga grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se dokumentacioni, si në formatin hard copy ashtu edhe në formatin soft copy, është administruar nga PMU. Aplikimet e dorëzuara janë hapur në datën 04.06.2018 nga katër anëtarë të komisionit të përcaktuar në urdhrin nr. 38, datë 31.05.2017, të titullarit të KESH, konkretisht nga E.B., F.B., B. K. dhe A.G..

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit referues u konstatua se ofertat nuk janë dorëzuar në protokollin e insitucionit ku të jetë e dokumentuar data e dorëzimit të ofertës në KESH SHA.

Referuar shkresës së mbajtur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit institucional (pa datë dhe pa nr. protokollit), kanë shprehur interes 5 kompani si më poshtë:

1. C. A.S.
2. A. G
3. J..
4. JV
5. A.D.

**Nga auditimi konstatohet se:**

Për shkak të mungesës së informacionit mbi procesin e protokollimit të dokumentacionit parakualifikues të dorëzuar nga shoqëritë konsulente, grupi i auditimit të KLSH kërkoi informacion pranë protokollit të KESH SHA.

### Vlerësimi i Komisionit për Fazën Parakualifikuese

5 (pesë) shoqëritë i kanë dorëzuar aplikimet përpara skadimit të afatit të dorëzimit tek PMU. Afati për dorëzimin e aplikimeve, është përcaktuar se dorëzimi brenda afatit të përcaktuar të dorëzimit tek KESH sha do të merret në konsideratë.

Në vijim vlerësimi i aplikimeve është kryer për të 5 (pesë) shoqëritë, si vijon:

#### 2. Vlerësimi i përputhshmërisë administrative

Të gjithë aplikantët kanë plotësuar këtë kriter dhe kanë dorëzuar dokumentet e kërkuara në dokumentet e parakualifikimit si vijon:

- d) Deklarata e marrjes përsipër
- e) Plotësia e Aplikimit
- f) Evidencë për burimet Financiare
- g) Evidencë për eksperiencën të ngjashme

### Në përfundim, janë kualifikuar për të vijuar me vlerësimin teknik dhe financiar 2 shoqëri konsulente:

1. A.
2. J..H.

### Vlerësimi për Pikëzimin

**Referuar dokumentit të parakualifikimit, Seksioni I - Parashikime të Përgjithshme, pika 3 Dorëzimi i aplikimeve, nënpika 4.2.4 Punëdhënësi do të refuzojë një aplikim nëse nuk janë plotësuar kushtet minimale, kushtet janë plotësuar nga:**

6. A.
7. J..H.

Kushtet nuk janë plotësuar nga aplikimet si vijon:

1. C.
2. J.
3. A.D.

KfW ka aprovuar vlerësimin e parakualifikimit me shkresën datë 06.11.2018 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit të Parakualifikimit”.

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit, me email datë 06.11.2019 ka njoftuar të 5 (pesë) aplikantët e mësipërm mbi rezultatet e vlerësimit.

### Hartimi i dokumenteve të tenderit

Me email datë 06.11.2018 janë njoftuar aplikantët e pa-suksesshëm mbi rezultatet e vlerësimit si dhe në bashkëpunim me PCU dhe KfW kanë përgatitur dokumentet e tenderit, të cilat KfW i ka aprovuar me shkresën datë 14.05.2019 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Dokumentet e Tenderit”.

### **Faza e dytë e vlerësimit**

Pas njoftimit të tenderit, PMU ka ftuar 2 shoqëritë e parakualifikuara, të cilat kishin plotësuar kriteret e parakualifikimit, për të dorëzuar ofertat e tyre teknike dhe financiare, të ndara nga njëra-tjetra.

**Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, konstatohet se ofertat e operatorëve nuk janë dorëzuar në protokollin e institucionit si dhe nuk dokumentohet koha e dorëzimit në KESH SHA.**

Ka dorëzuar ofertën vetëm:

1. A.

**Nga auditimi konstatohet se:**

Ofertat e paraqitura nga kompanitë e kualifikuara nuk janë dorëzuar në protokollin e institucionit.

Vlerësim i ofertave teknike:

Oferta teknike është dorëzuar brenda afatit vetëm nga 1 (një) aplikanti i parakualifikuar. PMU ka marrë vetëm 1 ofertë në dorëzim përpara afatit të parashikuar të dorëzimit, datë 22.07.2019, ora 14:00, ofertën e A.

Kriteret e Vlerësimit

Metoda e vlerësimit e aplikuar referuar udhëzuesve të prokurimit të KfW është “përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto (QCBS)”.

Gjatë fazës së vlerësimit të propozimeve teknike aplikantët duhet të vlerësohen me minimalisht 75 pikë për të vazhduar më tej me hapjen e ofertave financiare.

Rezultatet e vlerësimit teknik

-A. me 72 pikë

KfW ka aprovuar vlerësimin e ofertave teknike me shkresën datë 26.09.2019 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit Teknik”.

Vlerësimi i Propozimeve Financiare

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit teknik, në datën 26.09.2019, nga PMU në datë 30.09.2019 është hapur oferta financiare nga ku rezulton si vijon:

1. Oferta totale financiare e ofruar nga A. është 13,964,100.00 euro e vlerësuar me 100 pikë

Vlerësimi i kombinuar teknik dhe financiar:

Formula për vlerësimin e kombinuar teknik dhe financiar, ku 80% i takon vlerësimit teknik dhe 20% vlerësimit financiar, është:  $S=(T*0.8) + (F*0.2)$

Ku:

- S është rezultati përfundimtar i ofertuesit.
- T është rezultati i vlerësimit teknik (pikët e marra).
- F është rezultati i vlerësimit financiar (i konvertuar në pikë).

Vlerësimi financiar llogaritet sipas formulës:

$$F = \left( \frac{P_{min}}{P} \right) * 100$$

Ku:

- $P_{min}$  është çmimi më i ulët i ofertuar.
- $P$  është çmimi i ofertuesit që po vlerësohet.

Rezultatet e Vlerësimit të Kombinuar

Nga auditimi konstatohet se vlerësimi i kombinuar për:

1. Vlerësimi i kombinuar për aplikantin A. me 77.6 pikë

Bazuar në këto rezultate është rekomanduar për fitues aplikanti A. me ofertën 13,964,100 euro.

Me shkresën datë 15.10.2019 KfW ka shprehur se “nuk ka kundërshtime për raportin përfundimtar të vlerësimit”.

### Hartimi i Kontratës së Konsulentit

Në vijim Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me PMU dhe KfW kanë përgatitur dokumentin e kontratës së shërbimeve të konsulencës, të cilën KfW e ka aprovuar me shkresën datë 18.12.2019 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Draft Kontratën”.

Pas aprovimit të raportit të Dokumentit të Kontratës, është lidhur kontrata midis KESH SHA dhe A. datë 27.12.2019.

### **-Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Konsulenti i Implementimit të Qendrës së kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e Drinit”.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Njoftimi i parakualifikimit për prokurimin “Konsulenti i Implementimit të Qendrës së kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e Drinit” është botuar në website “gtai.de” në datën 11.01.2018, në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW (pika 2.5.1 “Publikimi i njoftimit për tender”) dhe tek gazeta Panorama.

#### Afati për dorëzimin e aplikimeve:

Afati për dorëzimin e aplikimeve ka qenë data 13.02.2018.

Afati i vendosur është në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane Për Zhvillim KfW, pika 2.4.10 Afatet e dorëzimit, (1) dorëzimi i aplikimeve, ku citohet se afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 30 dite kalendarike.

#### Hartimi i dokumentacionit parakualifikues:

KfW ka aprovuar dokumentet e parakualifikimit me shkresën e datës 11.01.2018 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me dokumentet e parakualifikimit”.

#### Komisioni i vlerësimit të procedurës së prokurimit:

Me urdhër nr.15, datë 07.02.2018 dhe rishikuar me urdhrin nr. 9 datë 20.02.2018, titullari i KESH ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit me objekt: “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për konsulencë teknike për Qendrën e kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e Drinit”, me përbërje si më poshtë:

- T.H. – Kryetar
- F.B. – Anëtar
- E.B. – Anëtare
- A. M. – Anëtar
- E. K. - Anëtar

Me urdhër nr.9, datë 20.02.2019 ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit me objekt: “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për konsulencë teknike për Qendrën e kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e Drinit”, me përbërje si më poshtë:

- F.B.– Kryetar
- L.B. – Anëtar
- A. P. – Anëtar
- A. M. – Anëtar
- E. K. - Anëtar

Në ftesën për oferta ka një përshkrim të shkurtër të Projektit dhe masave të synuara: Programi për Sigurinë e Digave, i cili është në zbatim e sipër dhe që përfshin investime të ndryshme që përqendrohen në energjinë hidroelektrike dhe sigurinë e digave në Kaskadën e Lumit Drin. Projekti i propozuar në kuadër të bashkëpunimit financiar gjerman me Shqipërinë është pjesë e Projektit për Sigurinë e Digave për tre hidrocentralet (HEC-et) Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës në kaskadën e lumit Drin.

Implementimi i një Qendre Monitorimi dhe Dispeçerimi të Digave (DMDC) bazohet në një Studim Fizibiliteti të kryer nga kompania inxhinierike F., Konsulenca e zbatimit për Qendrën e Monitorimit dhe Dispeçerimit të Digave për Kaskadën e Lumit Drin përfshin punimet e projektimit, proceset e tenderimit për punimet dhe mallrat, mbikëqyrjen e punimeve dhe procedurat e marrjes në dorëzim.

Objektivi i Shërbimeve të Konsulencës për Projektin e propozuar është të ofrojë shërbime të plota, gjithëpërfshirëse dhe profesionale duke ndihmuar Njësinë e Menaxhimit të Projektit (PMU) të KESH-it si vijon:

- Kryerja e Projektimit Paraprak për DMDC-në për HEC-et e Kaskadës së Lumit Drin.
- Përgatitja e dokumenteve të tenderit, duke përfshirë kërkesat e punëdhënësit për kontratën përkatëse, sipas udhëzimeve të prokurimit të lëshuara nga KfW ,
- Ndihma në prokurimin e mallrave dhe punimeve bazuar në udhëzimet e prokurimit të KfW dhe bazuar në Librin e Verdhë të FIDIC,
- Negocimi dhe menaxhimi në mënyrën më fitimprurëse të kontratës për KESH-in,
- Mbikëqyrja e punimeve dhe ndihma e NJMP-së duke synuar cilësinë optimale të punimeve dhe mallrave me kostot më të arsyeshme dhe periudhën më të shkurtër të nevojshme të zbatimit. Shërbimet e kërkuara nga konsulentët përfshijnë ofrimin e ekspertizës në inxhinieri, projektim dhe shërbime të menaxhimit të projektit për të siguruar dorëzimin në kohë të projektit. Konsulenti do të ofrojë ndihmë për KESH-PMU në aktivitetet që lidhen me zbatimin e Projektit. Objekti i Punimeve është si më poshtë:

1. Shërbime para-ndërtimi (Asistenca teknike do të ofrohet për të ndihmuar KESH-in që nga fazat e përgatitjes së projektimit paraprak dhe të dokumenteve të tenderit deri në kontraktimin e DMDC-së).
2. Ndihmë në Menaxhimin e Projekteve.
3. Rishikimi i projektit të detajuar të Kontraktorit dhe dorëzimeve të tjera sipas rastit,
4. Mbikëqyrja e punimeve të Kontraktorit në vend. Konsulenti do të veprojë si Inxhinier sipas Librit të Verdhë të FIDIC. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së ekzekutimit të punimeve (prodhimi, instalimi, testimi dhe vënia në punë e pajisjeve), Konsulenti duhet t'i ofrojë Punëdhënësit ndihmë dhe mbështetje të përgjithshme praktike në menaxhimin e projektit.
5. Monitorimi i Sistemit të Shëndetit dhe Sigurisë së Kontraktorit dhe Planit të Mbrojtjes së Mjedisit.
6. Inspektime në vendndodhjen e prodhuesit të komponentëve kryesorë.
7. Raportimi.

-Shërbimet do të ofrohen nga një ekip i përbërë nga konsulentë ndërkombëtarë ; p.sh., Ekspert i Inxhinierisë së Kontrollit Dixhital, Mbrojtjes dhe Matjes (Menaxher Projekti), Ekspert i Telekomunikacionit dhe SCADA-s, Ekspert Elektrike/Mekanike, Ekspert i Gjeologjisë/Sizmikës, Ekspert i Hidrologjisë/Hidroteknikës, Ekspert i Inxhinierisë Civile/Gjetjeve, Ekspert i Prokurimit, Financës dhe Administrimit të Kontratave, Ekspert i Vënies në Komision/Kontrollit të Cilësisë, Menaxher i HSE-së dhe staf tjetër mbështetës profesional dhe administrativ. Menaxheri i Projektit duhet të ketë të paktën 15 vjet përvojë profesionale në projekte të ngjashme. Specialistët e tjerë duhet të kenë të paktën 10 vjet përvojë profesionale në fushat e kërkuara. Kualifikimi kryesor për stafin e prokurimit, financës dhe

administrimit të kontratave duhet të jetë administrimi i kontratave. Do të vihen në dispozicion shërbime efikase menaxhimi dhe mbështetjeje.

-Konsulentët janë të lirë të bashkohen me firma të tjera për të siguruar që të gjitha njohuritë dhe përvojat e kërkuara janë në dispozicion të tyre.

-Dokumenti i parakualifikimit në gjuhën angleze duhet të ketë strukturën dhe përmbajtjen e mëposhtme dhe duhet të paraqitet në të njëjtën sekuencë siç tregohet më poshtë:

Letër Motivuese , që përfshin emrin e firmës, adresën, personin e kontaktit, numrin e telefonit, faksin dhe email-in, nëse është e aplikueshme,.

Prezantimet e firmave (maksimumi 10 faqe), përfshirë deklaratat të qarta të llojit, pronës dhe detyrës kryesore të shoqatës, nëse është e aplikueshme.

Deklaratat dhe Plotësimet (në rast të një shoqate, duhet të ofrohen nga të gjithë partnerët e asociuar; nënkontraktorët nuk kanë nevojë të ofrojnë Deklaratë dhe Plotësime) :

a) Deklaratë për dorëzimin e një propozimi në rast se jeni përfshirë në listën e ngushtë (mungesa e deklaratës çon në skualifikim).

b) Deklaratë mbi lidhjet e çdo lloji me firma të tjera që mund të paraqesin konflikt interesi në ofrimin e shërbimeve të parashikuara.

c) Në rast të një shoqate - marrëveshja kontraktuale e synuar me firmat ndërkombëtare dhe lokale, duke emëruar konsulentin kryesor dhe duke përfshirë letrat e qëllimit të firmave pjesëmarrëse (në rastin e partnerëve lokalë, një kopje faksi e letrave të tilla të qëllimit është e mjaftueshme).

d) Deklaratë për të respektuar standardin më të lartë të etikës gjatë ekzekutimit të kontratës.

e) Deklaratë e certifikuar e kapacitetit financiar të konsulentit kryesor dhe të gjithë partnerëve të lidhur që tregon një xhiro vjetore minimale prej më shumë se 1.5 milion euro gjatë tre viteve të fundit, ku partneri kryesor duhet të arrijë 80% të kësaj vlere.

-Lista e referencave të projektit të kryera nga konsulenti kryesor dhe partnerët e asociuar që mbulon rrjedhën e 10 viteve të fundit dhe lidhet ngushtë me shërbimet e parashikuara (maksimumi 15 referenca me 5 referenca të shënuara qartë të cilat do të vlerësohen sipas skemës së vlerësimit të dhënë në seksionin 11) .

-CV të shkurtra. duke përfshirë të gjithë informacionin e kërkuar mbi personelin e propozuar për mbështetje që tregojnë përvojën e përgjithshme dhe përshtatshmërinë për shërbimin.

-Lista e strukturës së personelit të disponueshëm për shërbimet e parashikuara me informacion në lidhje me arsimin, përvojën profesionale, përvojën rajonale në vendet e Evropës Juglindore, vitet në firmë, përvojën specifike në lidhje me projektin dhe përvojën në poste të ngjashme. Kjo listë (duke përfshirë stafin ndërkombëtar dhe stafin mbështetës të Zyrës së Brendshme) do të lejojë një gjykim të thellë mbi aftësinë e përgjithshme të konsulentëve për të ofruar personelin e kërkuar që ka përvojën specifike për projektin në rast të një oferte. Personeli që i përket firmës për 5 ose më shumë vjet ose që ka një bashkëpunim të gjatë merr më shumë pikë.

-Konsulentëve të interesuar u kërkohet të paraqesin dokumente koncize dhe të qarta, por thelbësore, si dhe t'i përmbahen strukturës së mësipërme. Mosrespektimi i kësaj ftese ose informacioni i gabuar do të çojë në moskualifikim. Çdo informacion i tepërt që nuk është specifik për materialin e kërkuar do të penalizohet.

-Propozimi për parakualifikim duhet të dorëzohet ose të dorëzohet në një kopje origjinale dhe një kopje në KESH. Përveç kësaj, një kopje duhet të dorëzohet në KfW dhe një kopje te Agjenti i Tenderit (TA) në adresat si më poshtë dhe jo më vonë se data e treguar në njoftim. Në rast të ndryshimeve midis dokumenteve, mbizotëron versioni origjinal. Për dorëzimin në kohë, marrja e origjinalit në KESH do të jetë vendimtare. Dorëzimi me anë të Email-it ose Faksit përjashtohet.

## **Faza e parë**

### Vlerësimi paraprak

-Referuar dokumentacionit të administruar (hard copy) nga grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se dokumentacioni, si në formatin hard copy ashtu edhe në formatin soft copy, është administruar nga PMU. Aplikimet e dorëzuara janë hapur në datën 13.02.2018 nga dy anëtarë të komisionit konkretisht nga E.B. dhe nga A. M..

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit referues u konstatua se ofertat nuk janë dorëzuar në protokollin e institucionit ku të jetë e dokumentuar data e dorëzimit të ofertës në KESH SHA.

Referuar shkresës së mbajtur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit institucional (pa datë dhe pa nr. protokollin), kanë shprehur interes 7 shoqëri konsulente si më poshtë:

1. G., Gjermani
2. F, Gjermani
3. I.SA, Switzerland
4. L. I. GmbH, Gjermani
5. V. H. GmbH, Austria
6. A. C. Switzerland
7. St. I., Italia

### **Nga auditimi konstatohet se:**

-Për shkak të mungesës së informacionit mbi procesin e protokollimit të dokumentacionit parakualifikues të dorëzuar nga shoqëritë konsulente, grupi i auditimit të KLSH kërkoj informacion pranë protokollit të KESH.

-Zyra e protokollit pranë KESH nuk ka mbajtur procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit parakualifikues tek NJKP.

### Vlerësimi i Komisionit për Fazën Parakualifikuese

Më datë 26.06.2018, komisioni ka kryer vlerësimin e fazës parakualifikuese për konsulencë si vijon:

1. Kryerja e projektimit paraprak për DMDC-në për HEC-et e Kaskadës së Lumit Drin.
2. Përgatitja e dokumenteve të tenderit, duke përfshirë kërkesat e KESH për kontratën përkatëse, sipas udhëzimeve të prokurimit të lëshuara nga KfW,
3. Ndihma në prokurimin e mallrave dhe punimeve bazuar në udhëzimet e prokurimit të KfW dhe bazuar në Librin e Verdhë të FIDIC,
4. Negocimi dhe menaxhimi në mënyrën më fitimprurëse i kontratës për NJMP-në,
5. Mbikëqyrja e punimeve dhe ndihma e NJMP-së duke synuar cilësinë optimale të punimeve dhe mallrave me kostot më të arsyeshme dhe periudhën më të shkurtër të nevojshme të zbatimit.

KfW dhe KESH kanë rënë dakord të emërojnë konsulentin e zbatimit përmes një procedure ndërkombëtare, me ftese publike për tender në përputhje me Seksionin nr. 2 të Udhëzimeve të KfW për Caktimin e Konsulentëve. Rezultati i Tenderit do të jetë një kontratë me një firmë të vetme ose një grup firmash për të gjitha shërbimet e përskruara më sipër. KfW, në emër të KESH, ka lidhur një kontratë me një Ekspert Teknik (TE), V. P., për të ofruar mbështetje në zbatimin e Tenderit, në përputhje me nenin 1.05 të Udhëzimeve.

Në përputhje me nenin 52.01 të Udhëzimeve, tenderi është zbatuar në dy hapa, parakualifikim dhe tenderim konkurrues.

NJMP ka përgatitur dokumentin e parakualifikimit (PQ), në përputhje me Udhëzimet e KfW për Parakualifikimin e Konsulentëve, KfW ka dhënë mos-kundërshtimin e saj (no objection) ndaj PQ-së dhe njoftimit të prokurimit, në përputhje me nenin 2.03 të Udhëzimeve, më 4.01.2018.

Pas mos-kundërshtimit të KfW ndaj dokumenteve parakualifikuese, eksperti teknik ka publikuar njoftimet, në përputhje me Udhëzimet nr. 2.03, në GTAI më 11.01.2018 dhe në Devex më 13.01.2018. Njoftimi është publikuar në DgMarket dhe Devex më 15.01.2018 dhe në dy gazeta me qarkullim kombëtar në Shqipëri, Panorama dhe Gazeta Shqiptare më 17.01.2018 dhe 18.01.2018.

Afati i fundit për dorëzimin e shprehjeve të interesit ishte data 12.02.2018

Sqarimet e ofertueseve kanë rezultuar në modifikimin e kritereve të vlerësimit 1.1 (për të shpjeguar më mirë kërkesat ndaj projekteve referuese) dhe 1.2 (për të korrigjuar një gabim aritmetik në skemën e pikëzimit).

Vlerësimi i kërkesës për interes është kryer nga eksperti teknik dhe është shqyrtuar nga NJMP. Vlerësimi u krye në bazë të dokumenteve që përbënin kërkesën për interes të paraqitura nga ofertuesit.

*Në përfundim, janë kualifikuar për të vijuar me vlerësimin teknik dhe financiar 5 shoqëri konsulente:*

Në përputhje me kërkesat e përcaktuara, lista duhet të përbëhet nga jo më shumë se pesë ofertues të renditur më lart, të cilët kanë paraqitur një kërkesë për interes të përgjegjshme, duke përfshirë aftësinë financiare për të kryer detyrën, dhe kanë marrë të paktën 70 pikë. Zbatimi i kritereve të mësipërme, ka rezultuar në listën e shkurtër të mëposhtme, e cila është rekomanduar për shqyrtim nga KfW, për t'u ftuar të paraqesë propozimin teknik dhe financiar:

*Vlerësimi për Pikëzimin*

**Referuar dokumentit të parakualifikimit, Seksioni I - Parashikime të Përgjithshme, pika 3 Dorëzimi i aplikimeve, nënpika 4.2.4 Punëdhënësi do të refuzojë një aplikim nëse; (b) Aplikanti është vlerësuar me më pak se 70 pikë.**

**Referuar këtij kushti janë vlerësuar me mbi 70 pikë aplikimet si vijon:**

- |                               |            |
|-------------------------------|------------|
| 1. A. Switzerland             | 89.5 pikë  |
| 2. F. GmbH & Co. KG, Gjermani | 93 pikë    |
| 3. L. I. GmbH, Gjermani       | 78 pikë    |
| 4. I.                         | 72.25 pikë |

KfW ka aprovuar vlerësimin e parakualifikimit me shkresën datë 02.07.2018 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit të Parakualifikimit”.

*Hartimi i dokumenteve të tenderit*

Në vijim drejtori i NJMP, datë 07.11.2018 i ka dërguar të 4 (katër) aplikantëve të parakualifikuar ftesën për ofertë së bashku me setin e dokumenteve të tenderit, ku ka kërkuar konfirmim për marrjen e e-mailit dhe nëse janë të interesuar për pjesëmarrje në tender si dhe është përcaktuar edhe afati për dorëzimin e ofertave në datën 21.12.2018, duke plotësuar kushtin për afat të dorëzimit prej minimalisht 45 ditë kalendrike, sipas udhëzuesve të prokurimit të KfW pika 2.4.10 Afatet e dorëzimit, (2) dorëzimi i ofertave, ku citohet se “afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 45 ditë kalendrike”.

**Faza e dytë e vlerësimit**

Më date 08.07.2019, komisioni i vlerësimit të ofertave ka përgatitur raportin e vlerësimit.

Faza e parakualifikimit është përshkruar në mënyrë të detajuar në raportin e parakualifikimit, të cilit KfW i ka dhënë mos kundërshtim më datë 4.07.2018. Faza e tenderimit konkurrues konsiston në vlerësimin e propozimeve teknike dhe vlerësimin e kombinuar të teknikës dhe propozimet financiare. Vlerësimi i propozimeve teknike është përshkruar në mënyrë të detajuar në raportin e vlerësimit teknik, të cilit KIW i ka dhënë mos kundërshtim më datë 2.07.2019. Si rezultat i aplikimit të kriterëve të vlerësimit teknik në përputhje me ITC 21.1 (të gjitha referencat e ITC janë referenca në KPP), NJMP-ja ka dhënë këto pikë teknike:

**Tabela nr. 13**

E (Konsulent kryesor)	Rezultati teknik	Mbi pikën minimale teknike për vlerësimin e kombinuar teknik dhe financiar
AFC	90,34	po
F	84,90	po
I	52,40	jo

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

ITC 21.1 kërkon që punëdhënësi të refuzojë propozimet që nuk arrijnë të paktën 75% të fushës teknike maksimale. Rrjedhimisht, raporti i vlerësimit teknik përfundoi me rekomandimin e mëposhtëm:

NJMP ka rekomanduar shqyrtimin e propozimeve të A. dhe F, për vlerësimin e kombinuar teknik dhe financiar në përputhje me ITC 21.1.

**Nga auditimi konstatohet se:**

Nuk është mbajtur një procesverbal ndërmjet zyrës së protokollit të KESH dhe NJKP-së për marrjen në dorëzim të zarfave me ofertat teknike dhe financiare të këtyre shoqërive.

-Hapja dhe verifikimi i propozimeve financiare

Për shkak të vonesës në miratimin e raportit të vlerësimit teknik, NJMP-ja ka kërkuar që tenderët të zgjasin vlefshmërinë e propozimeve të tyre. NJMP-ja ka hapur propozimet origjinale financiare në prani të dëshmitarëve të shumtë më 3.07.2019. AT ka hapur kopjet e propozimeve financiare më 4.07.2019. Sipas raportit të vlerësimit teknik, u hapën vetëm propozimet financiare të A. dhe F,. Protokollet e hapjes së propozimeve financiare janë bashkangjitur në aneksin 2 të këtij raporti.

Sipas protokolleve të hapjes, nuk kishte mospërputhje midis çmimeve të cituara në origjinal dhe në kopjet e formularëve të paraqitjes së propozimeve financiare. Çmimet e shënuara në protokolle ishin:

F. 650,450.00 € neto nga taksat dhe tarifat e aplikueshme në Shqipëri

A. 439,100.00 € neto nga taksat dhe taksat e aplikueshme në Shqipëri

Sipas klauzolës 23 ITC-së. TOR 3.1-3.8), Konsulenti konsiderohet se i ka përfshirë të gjitha çmimet në Propozimin Financiar, prandaj nuk bëhen as korrigjime aritmetike dhe as rregullime të çmimeve. NJMP-ja ka verifikuar ndarjet e detajuara të çmimeve sipas sipër dhe ka bërë përcaktimet e mëposhtme:

**F.**

Çmimet nuk përmbajnë mospërputhje të brendshme, siç janë gabimet aritmetike të pasakta ose transferimet e pasakta të shumave të përkohshme.

Niveli i përpjekjes së cituar në propozimet financiare është në përputhje me nivelin e përpjekjes së cituar në propozimin teknik.

Tarifa e vetme e cituar për secilën kategori ekspertësh (22,000 € në muaj me ngarkesë të plotë) është tipike për ekspertët e lartë dhe në përputhje me cilësinë e personelit të ofruar nga F, në propozimin teknik.

**A.**

-Niveli i përpjekjes së cituar në propozimet financiare është në përputhje me nivelin e përpjekjes së cituar në propozimin teknik në komponentin A.

-Në komponentin B të bazuar në kohë (shërbimet e periudhës së përgjegjësisë për defektet), A. citoi një total prej 0.28 muajsh të ndarë midis dy kategorive të ekspertëve, një fluturim ndërkombëtar dhe 2 ditë akomodim, në vend të 0.90 muajsh, 4 fluturime ndërkombëtare dhe 20 ditë akomodim siç kërkohet në RFP (shih ITC 16.1). Për të siguruar përputhshmërinë me RFP dhe krahasueshmërinë me propozimin financiar të F,, këto sasi u rregulluan.

-Tarifat e cituara për secilën kategori ekspertësh (10,725-22,260 € në muaj të ngarkuara plotësisht në varësi të kategorisë së ekspertëve) janë tipike për ekspertët e nivelit të lartë dhe të mesëm dhe në përputhje me cilësinë e personelit të ofruar nga A. në propozimin teknik.

Verifikimi i detajuar i çmimeve dhe korrigjimet dhe rregullimet e propozuara në çmimin e A. janë dhënë në spreadsheet-in Price reconciliation.xls të bashkangjitur në Shtojcën 2 të këtij raporti. Korrigjimet dhe rregullimet kanë rezultuar në çmimet e mëposhtme të cituara nga ofertuesit:

Propozimi i F,: 650,450.00 € neto nga taksat dhe taksat e zbatueshme në Shqipëri, nuk janë bërë korrigjime.

Propozimi i A.: 439,100.00 € neto nga taksat dhe taksat e zbatueshme në Shqipëri, i korrigjuar në 456,546.00 €.

-Vlerësimi i kombinuar teknik dhe financiar

Sipas ITC 26.1, rezultatet e kombinuara teknike dhe financiare të propozimeve të kualifikuara do të llogariten sipas metodës së mëposhtme:

Peshat e dhëna për Propozimet Teknike (T) dhe Financiare (F) janë:  $W_t=70\%$ , dhe  $W_f = 30\%$   
 Nota Teknike e Propozimit do të llogaritet si më poshtë:  $PTWTT/To$ , me  $W1$  = peshë që i jepet Propozimit Teknik,  $P1$  = rezultati i atribuar për vlerësimin teknik, vlerësimi më i lartë teknik për propozimin teknik, Rezultati 'teknik' i të gjithë Konsulentëve. Rezultati financiar i Propozimit do të llogaritet si më poshtë:  $Pf=Wf*Fo/F$ , me  $Wf$  = peshën dhënë Propozimit Financiar,

$P_{\{F\}}$  = rezultati i atribuar për Propozimin Financiar (pikë),

$F$  = Çmimi i korrigjuar i Konsulentit për Propozimin Financiar,

$F_{\{0\}}$  = Propozimi Financiar më i ulët i korrigjuar.

Rezultati Total i Propozimit do të llogaritet si  $P = P_{\{F\}} + P_{\{T\}}$

Tabela e mëposhtme tregon zbatimin e metodës së mësipërme në vlerësimin e kombinuar teknik dhe financiar të propozimeve të F, dhe A.

**Tabela nr.14**

Konsulent	Pikët e ofertuesit në vlerësimin teknik (T)	Pikët më të larta të 'teknike' nga të gjithë ofertuesit ( $T_{\{0\}}$ )	Pikët e atribuara për Propozimin Teknik (PT)	Propozimi Financiar i korrigjuar i ofertuesit (C)	Propozimi Financiar më i ulët i korrigjuar ( $C_{\{0\}}$ )	Pikët e atribuara për Propozimin Financiar (PF)	Pikët Totale
F,	84.90	90.34	65.78	650,450.00€	456,546.00€	21.06	86.84

A.	90.34		70.00	456,546.00€		30.00	100.00
----	-------	--	-------	-------------	--	-------	--------

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

-Rekomandimi i NJMP ka qenë për lidhjen e kontratës me A. si ofertuesi më i renditur në përputhje me ITC 26.1.-

**-Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Implementimi i Qendrës së kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e lumit Drinit” .**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Njoftimi i parakualifikimit për prokurimin “Implementimi i Qendrës së kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e Drinit” është botuar në website “gtai.de” në datën 07.05.2020, në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW (pika 2.5.1 “Publikimi i njoftimit për tender”) dhe tek gazeta Panorama.

Afati për dorëzimin e aplikimeve:

Afati për dorëzimin e aplikimeve ka qenë data 08.06.2020.

Afati i vendosur është në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane Për Zhvillim KfW, pika 2.4.10 Afatet e dorëzimit, (1) dorëzimi i aplikimeve, ku citohet se afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 30 dite kalendarike.

Në lidhje me dokumentet për tu dorëzuar, afati i dorëzimit 08.06.2020 është ndryshuar më datë 22.06.2020.

Hartimi i dokumentacionit parakualifikues:

KfW ka aprovuar dokumentet e parakualifikimit me shkresën e datës 27.04.2020 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me dokumentet e parakualifikimit”.

Komisioni i vlerësimit të procedurës së prokurimit:

Me urdhër nr.47, datë 18.06.2020 titullari i KESH ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit me objekt: “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për krijimin e Qendrës së kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e lumit Drinit”, me përbërje si më poshtë:

- T. B. – Kryetar
- F.B.– Anëtar
- E. B. – Anëtare
- B. L. – Anëtar
- O. M. - Anëtar

Në ftesën për oferta ka një përshkrim të shkurtër të Projektit dhe masave të synuara:

Një Qendër e re e Monitorimit dhe Dispeçerimit të Digave për Kaskadën e Lumit Drin do të instalohet në selinë qendrore të Punëdhënësit (Qendra Qendrore e KESH) në Tiranë me një server rezervë në Hidrocentralin (HEC) të Vaut të Dejës për të kontrolluar tre HEC-et (Fierza, Komani dhe Vau i Dejës) të Kaskadës së Lumit Drin. Brenda fushëveprimit të këtij projekti, kontraktori do të duhet të ndërmarrë përshtatje civile në zonën e dhomës së kontrollit në selinë qendrore të KESH, duke përfshirë furnizimin dhe instalimin e ndriçimit, sistemit HVAC, etj.

## **Faza e parë**

### Vlerësimi paraprak

Procesi i përzgjedhjes në fazën parakualifikuese është vendosur të bëhet në platformën elektronike e-Procurement platform. Exficom GmbH, e mandatuar nga KfW.

Më datë 20.01.2021, në website GTAI është publikuar njoftimi, për operatorët e zgjedhur në fazën e parakualifikimit.

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit referues u konstatua se ofertat nuk janë dorëzuar në protokollin e institucionit ku të jetë e dokumentuar data e dorëzimit të ofertës në KESH SHA.

Referuar deklaratimit të GTAI janë paraqitur 8 (tetë) operatorë dhe janë përzgjedhur dy operatorë që plotësojnë kushtet e parakualifikimit:

1. J.
2. A.
3. J.
4. A.
5. E.
6. K.
7. J.
8. S.

### Vlerësimi i Komisionit për Fazën Parakualifikuese

Fillimisht është vlerësuar përgjigja e aplikimeve bazuar në kriteret:

1. Deklarata kryerjes
2. Deklarata për kapacitetet financiare dhe dokumentet mbështetëse
3. Forma e kërkesës për aplikim
4. Autorizimi i personit përfaqësues të aplikuesit
5. Nëse aplikanti është bashkim operatorësh kontrata e bashkëpunimit

Nga 8 aplikantët 6 janë skualifikuar dhe kanë kaluar fazën e parë A. Austri dhe K. and E., Kroaci. Në procesin e ofertimit në total K. ka marrë 98.069 pikë dhe A. ka marrë 97.853 pikë.

## **2.5 Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra, shërbime dhe konsulencë**

**Zbatimi i kontratës: “Konsulenti i Implementimit të Rehabilitimit të Portave të Shkarkimit të HEC Vau i Dejës”.**

Për zbatimin e projektit është lidhur kontrata e Konsulencës midis KESH SHA dhe F, datë 22.11.2017.

Nga auditimi rezulton se kontrata është ndryshuar 5 herë, konkretisht:

1. Amendimi nr. 1, datë 15.11.2019, zgjatje e periudhës së kontratës (nga 16 muaj në 26 muaj) pa kosto shtesë. Aprovimi nga KfW është dhënë me emailin e datës 11.10.2019.
2. Amendimi nr. 2, datë 27.03.2020, zgjatje e periudhës së kontratës (nga 26 muaj në 32 muaj) pa kosto shtesë. Aprovimi nga KfW është dhënë me emailin e datës 18.03.2020.
3. Amendimi nr. 3, datë 04.11.2020, zgjatje e periudhës së kontratës (nga 32 muaj në 53 muaj) dhe me një kosto shtesë prej 651,472 euro. Aprovimi nga KfW është dhënë me emailin e datës 04.11.2020.

4. Amendimi nr. 4, datë 04.07.2022, zgjatje e periudhës së kontratës (nga 53 muaj në 72 muaj) dhe me një kosto shtesë prej 416,387 euro. Aprovimi nga KfW është dhënë me emailin e datës 30.06.2022.
5. Amendimi nr. 5, datë 14.12.2023, zgjatje e periudhës së kontratës (nga 72 muaj në 96 muaj) dhe me një kosto shtesë prej 85,645 euro. Aprovimi nga KfW është dhënë me emailin e datës 30.06.2022.

**Në total vlera e kontratës së bashku me Amendimet ka shkuar 1,526,204 euro nga vlera prej 372,700.00 e kontraktuar fillimisht.**

**Deri në 31.12.2024 janë paguar 1,508,581,26 euro nga të cilat 1,455,803.98 janë shpenzime fikse dhe 52,787.28 euro shpenzime të rimbursueshme.**

**Nga auditimi konstatohet se ka një tej zgjatje të kontratës nga 10+6 muaj në 96 muaj si dhe një rritje të vlerës së saj për rreth 4 herë nga vlera e kontratës duke e denatyruar procesin e prokurimit, ku oferta e dhënë ka qenë në një sasi dhe kohë të caktuar.**

Aplikimi për disbursim nr. 1 datë 23.02.2018 me vlerë 37,270 euro.

- Fatura nr. D18/0037, datë 16.01.2018
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 27.04.2018
- Letra për autoriziminn e firmave nr. 871, datë 12.02.2018.

Aplikimi për disbursim nr. 2 datë 05.12.2019 me vlerë 69,860 euro.

- Fatura nr. D19/2971, datë 21.08.2019
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 19.12.2019

Aplikimi për disbursim nr. 3 datë 18.12.2019 me vlerë 52,395 euro.

- Kërkesa për tërheqje nr. 3 datë 18.12.2019
- Fatura nr. D19/3857, datë 21.08.2019.
- Aprovimin nga KfW për raportin përfundimtar të vlerësimit të tenderit.

Aplikimi për disbursim nr. 9 datë 11.08.2020 me vlerë 96,057.50 euro.

- Kërkesa për tërheqje nr. 9 datë 17.07.2020
- Fatura nr. D20/1571, datë 30.06.2020;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 27.10.2020;
- Deklaratë e detajuar si informacion plotësues për faturën.

Aplikimi për disbursim nr. 10 datë 30.09.2020 me vlerë 96,057.50 euro.

- Kërkesa për tërheqje nr. 10 datë 30.09.2020;
- Fatura nr. D20/2754, datë 31.08.2020;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 14.09.2020;
- Deklaratë e detajuar si informacion plotësues për faturën.

Aplikimi për disbursim nr. 13 datë 20.01.2021 me vlerë 86,353.14 euro.

- Kërkesa për tërheqje nr. 13 datë 11.01.2021;
- Fatura nr. D20/4383, datë 30.11.2020;
- Deklaratë e detajuar si informacion plotësues për faturën.

Aplikimi për disbursim nr. 17 datë 24.05.2021 me vlerë totale 95,420.22 euro

- Kërkesa për tërheqje nr. 17 datë 24.05.2021;
- Fatura nr. D21/0487, datë 30.11.2020;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 21.07.2021;
- Deklaratë e detajuar si informacion plotësues për faturën;
- Faturat nr. D21/0576, D21/0577 dhe D21/0918, datë 09.04.2021 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën totale 9,067.08 euro;

Aplikimi për disbursim nr. 20 datë 23.08.2021 me vlerë totale 97.993,26 euro

- Kërkesa për tërheqje nr. 20 datë 23.08.2021;
- Fatura nr. D21/1613, datë 01.06.2021 me vlerë 86,353.14 euro;

- Deklaratë e detajuar si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 28.10.2021;
- Fatura nr. D21/2039, datë 05.07.2021 dhe fatura nr. D21/2495, datë 02.08.2021 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën totale 11,640 euro;

Aplikimi për disbursim nr. 27 datë 19.10.2021 me vlerë totale 88,949.01 euro.

- Kërkesa për tërheqje nr. 27 datë 19.10.2021;
- Fatura nr. D21/2896, datë 02.09.2021 me vlerë 86,353.14 euro;
- Deklaratë e detajuar si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Pagesa për faturën e mësipërme është kryer nga KfW në datë 02.09.2021;
- Fatura nr. D21/3471, datë 15.10.2021 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën totale 2,595.87 euro;

Aplikim për disbursim nr. 30 datë 23.12.2021 me vlerë 86,353.14 euro.

- Fatura nr. D21/4194 datë 03.12.2021 në shumën 86,353.14 euro;
- Deklaratë e detajuar si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 22.06.2022.

Aplikim për disbursim nr. 38 datë 16.03.2022 me vlerë 93,011.31 euro.

- Fatura nr. D22/0668 datë 10.03.2022 në shumën 86,353.14 euro;
- Deklaratë e detajuar si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Fatura nr. D21/4595 datë 05.01.2022 dhe D22/0682 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën totale 6,658.17 euro;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 23.06.2022.

Aplikim për disbursim nr. 44 datë 25.07.2022 me vlerë 89,352.86 euro.

- Fatura nr. D22/1811 datë 03.06.2022 në shumën 86,353.14 euro;
- Deklaratë e detajuar si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Fatura nr. D22/1814 datë 03.06.2022 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën 2,999.72 euro;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 22.09.2022.

Aplikim për disbursim nr. 54 datë 17.10.2022 me vlerë 71,221.97 euro.

- Fatura nr. AR000466 datë 07.10.2022 në shumën 69,397.83 euro;
- Fatura nr. AR000467 datë 07.10.2022 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën 1,824.14 euro;
- Deklaratë e detajuar për periudhën Qershor-Gusht 2022 si informacion plotësues për faturën e mësipërme;

Aplikim për disbursim nr. 59 datë 20.12.2022 me vlerë 74,383.31 euro.

- Fatura nr. AR001536 datë 09.12.2022 në shumën 69,397.83 euro;
- Fatura nr. AR001537 datë 09.12.2022 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën 4,985.48 euro;
- Deklaratë e detajuar për periudhën Shtator-Tetor 2022 si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 01.02.2023.

Aplikim për disbursim nr. 65 datë 06.04.2023 me vlerë 70,938.47 euro.

- Fatura nr. AR003013 datë 10.03.2023 në shumën 69,397.83 euro;
- Fatura nr. AR003014 datë 10.03.2023 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën 1,540.64 euro;
- Deklaratë e detajuar për periudhën Dhjetor 2022- Shkurt 2023 si informacion plotësues për faturën e mësipërme.
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 12.05.2023.

Aplikim për disbursim nr. 72 datë 10.07.2023 me vlerë 72,733.89 euro.

- Fatura nr. AR004372 datë 22.06.2023 në shumën 69,397.83 euro;

- Fatura nr. AR004328 datë 22.06.2023 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën 3,336,06 euro;
- Deklaratë e detajuar për periudhën Mars -Maj 2023 si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 09.08.2023.

Aplikim për disbursim nr. 81 datë 17.10.2023 me vlerë 74,070.79 euro.

- Fatura nr. AR005577 datë 19.09.2023 në shumën 69,397.83 euro;
- Fatura nr. AR005578 datë 19.09.2023 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën 4,672.96 euro;
- Deklaratë e detajuar për periudhën Qershor-Gusht 2023 si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Pagesa është kryer nga KfW në datë 25.10.2023.

Aplikim për disbursim nr. 99 datë 28.12.2023 me vlerë 71,019.59 euro.

- Fatura nr. AR007338 datë 18.12.2023 me vlerë 69,397.83 euro;
- Fatura nr. AR007339 datë 18.12.2023 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën 1,621.76 euro;
- Deklaratë e detajuar për periudhën Shtator-Tetor 2023 si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Pagesa është kryer nga KfW në date 07.02.2024.

Aplikim për disbursim nr. 116 datë 13.03.2024 me vlerë 62,649.28 euro.

- Fatura AR0087890 datë 05.03.2024 me vlerë 60,804.00 euro;
- Fatura nr. AR008789 datë 05.03.2024 për shpenzime të rimbursueshme, në shumën 1,845.76 euro;
- Deklaratë e detajuar për periudhën Dhjetor 2023- Shkurt 2024 si informacion plotësues për faturën e mësipërme;
- Pagesa është kryer nga KFW në datë 28.03.2024.

Aplikim për disbursim nr. 117 datë 13.03.2024 me vlerë 24,841.00 euro.

- Shkresa përcjellëse e aplikimit për KfW;
- Fatura AR008878 datë 11.03.2024;
- Aplikimi për pagesë nr.117 sipas formatit të KfW;
- Garancia Bankare nr.240BGI2400103 datë 08.03.2024;
- Pagesa është kryer nga KFW në date 28.03.2024.

## **TVSH**

Referuar nenit 2.4 “Taksat” të Kushteve të veçanta

Punëdhënësi rimbursion taksat e paguara pas paraqitjes së provave sipas nenit 2.4.2. i Kushteve të Përgjithshme ku parashikohet pagesa e taksave nga Punëmarrësi.

Nga auditimi rezulton se pagesa e TVSH është kryer kundrejt paraqitjes së faturave të TVSH dhe pa sjell prova për pagesën e saj.

Bashkëlidhur kontrata si dhe Amendimet kanë një Preventiv “Price Breakdown” në lidhje me stafin dhe kohën si dhe mjete dhe sasitë. Nga auditimi konstatohet se nga ana e KESH sha nuk është kryer monitorim mbi përmbushjen e zërave të preventivit dhe nuk është hartuar ndonjë raport për këtë gjë.

**Zbatimi i kontratës: “Zbatimin e Punimeve Rehabilituese të Portave të Shkarkimit dhe Remontit të HEC Vau i Dejës”**

Amendimet e kontratës:

**Tabela nr.11**

Kontrata	Data e aprovimit	Shuma
Vlera fillestare	27.12.2019	13,964,100.00
Amendimi No. 2 Alternative Qyrfaq Stoplog System	19.05.2022	1,596,962.21
Amendimi No. 3 - Lead Contaminated Materials	Sep 2023	408,300.00
Variation VO-001 - Zadeja Stoplog and Stoplog Handling System	16.03.2021	479,486.50
Variation VO-002 - Control System	21.12.2021	78,400.90
<b>Total</b>		<b>16,527,249.61</b>

*Burimi i të dhënave: KESH SHA*

Pagesat e kryera për realizimin e kontratës:

**Tabela nr.12**

IPC	Activity/Remarks	Invoice date	Total Invoiced Amount [EUR]	Cumulative Amount [EUR]	% of Total	Certified Work Payment Net [EUR]
000	Advance Payment	23.01.20	2,094,615.00	2,094,615.00	12.67%	-
001	Mobilization Foreign	08.06.20	999,144.00	3,093,759.00	6.05%	1,387,700.00
002	Mobilization Local	08.06.20	150,420.00	3,244,179.00	0.91%	250,700.00
003	Progress 5 Nov 20	05.11.20	560,061.28	3,804,240.28	3.39%	933,435.47
004	Progress 31 Dec 20	25.01.21	253,922.61	4,058,162.89	1.54%	423,204.35
005	Progress 31 Mar 21	05.05.21	525,824.12	4,583,987.01	3.18%	876,373.53
-	Adv. Pay. VO-001	15.02.21	71,922.99	4,655,910.00	0.44%	-
006	Progress 30 Jun 21	19.07.21	293,899.07	4,949,809.07	1.78%	489,831.79
007	Progress 30 Jul 21	30.07.21	256,503.52	5,206,312.60	1.55%	427,505.87
008	Progress 30 Sep 21	14.10.21	110,384.46	5,316,697.06	0.67%	183,974.10
009	Progress 30 Oct 21	24.11.21	190,478.84	5,507,175.89	1.15%	317,464.73
010	Progress 30 Nov 21	10.01.22	223,370.25	5,730,546.14	1.35%	372,283.75
011	Progress 31 Dec 21	19.01.22	189,610.25	5,920,156.40	1.15%	316,017.09
012	Progress 31 Jan 22	15.02.22	279,193.67	6,199,350.06	1.69%	465,322.78
013	Progress 28 Feb 22	04.04.22	127,206.01	6,326,556.06	0.77%	212,010.01
-	Adv. Pay. VO-002	15.02.22	11,760.13	6,338,316.19	0.07%	-
014	Progress 30 Jun 22	21.07.22	575,637.99	6,913,954.18	3.48%	83,855.70
-	Adv. Pay. Amend. #2	21.07.22	239,544.33	7,153,498.51	1.45%	-
015	Progress 31 Aug 22	30.09.22	533,361.39	7,686,859.90	3.23%	888,935.65
016	Progress 30 Oct 22	15.11.22	909,796.82	8,596,656.73	5.50%	1,516,328.04
017	Progress 31 Dec 22	31.01.23	1,085,280.14	9,681,936.87	6.57%	1,808,800.24
018	Progress 31 Jan 23	10.02.23	462,726.67	10,144,663.54	2.80%	771,211.12
019	Progress 28 Feb 23	20.03.23	357,330.52	10,501,994.05	2.16%	595,550.86
020	Progress 30 Apr 23	10.05.23	393,896.05	10,895,890.10	2.38%	656,493.42
021	Progress 31 May 23	15.06.23	123,056.81	11,018,946.91	0.74%	205,094.69
022	Progress 30 Jun 23	10.07.23	114,470.78	11,133,417.69	0.69%	190,784.63
023	Progress 31 Jul 23	09.08.23	325,980.02	11,459,397.73	1.97%	543,300.04
024	Progress 31 Aug 23	19.09.23	468,424.19	11,927,821.90	2.83%	780,706.98
025	Progress 30 Sep 23	10.10.23	390,528.46	12,318,350.37	2.36%	650,880.77
026	Progress 31 Oct 23	17.11.23	1,032,433.52	13,350,783.88	6.25%	547,882.30
-	Adv. Pay. Amend. #3	17.11.23	61,245.00	13,665,978.62	0.37%	-
027	Progress 30 Nov 23	30.11.23	199,796.30	13,727,223.62	1.21%	332,993.83
	Reten. Part II Zadeja	17.11.23	315,194.74	13,927,019.91	1.91%	-
028	Progress 21 Dec 23	20.12.23	849,518.25	14,776,538.15	5.14%	298,607.89
	Reten. Part II Qyrfaq	19.02.24	924,348.98	15,700,887.13	5.59%	-
029	PC Zadeja	19.02.24	210,129.83	15,911,016.96	1.27%	-

030	PC Qyrmaq	19.02.24	616,232.65	16,527,249.61	3.73%	
<b>Total</b>			<b>16,527,249.61</b>	<b>16,527,249.61</b>	<b>100.00%</b>	<b>16,527,249.61</b>

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

### Marrja në dorëzim

Me urdhrin e Administratorit nr. 455, datë 04.02.2023 është ngritur grupi i punës për komisionimin e Portave të shkarkimit, grupi i përbërë prej 18 punonjësish.

Nga ana e KESH Sha nuk u vendos në dispozicion dokumentacioni i hartuar nga Grupi i punës.

### Zbatimi i kontratës: “Konsulenti i Implementimit të Qendrës së kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e Drinit”

Kontrata pati një shtesë në vlerën 54,712 euro duke arritur në total në 511,258 euro.

### Tabela nr.15

Nr.i amendimeve	Data	Ndryshimet	Ndikim financiar
1	19.12 . 2019	Ndryshim një llogarie bankare	asnjë
2	25 05.2020	A . transferim	asnjë
3	05.07.2022	Ndryshimi i fushëveprimit dhe periudhës së përfundimit	po
4	09.10.2023	Zgjatje e periudhës së përfundimit për të 73 muaj një dhe ndryshimi i DNP shërbimeve nga në pagesë të bazuar në kohë në lump sum pagesë	asnjë

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

Pagesat e kryera ndaj Konsulentit.

### Tabela nr.16

Skeduli i pagesave						
Pagesat e tarifave fikse	%	Faturat e JV për Klientin				
		Faturë nr.	data	EUR Përveç TVSH	Paguara	paga ( datë )
1	86 %	10090_4558-01	12.12.2019	40,000	39,950	05.02.2020
2	15.1%	10090_4558-02	30.04.2021	70,000	69,950	10.06.2021
3	28 0%	10090_4558-03	27.12. 2021	130,000	129,950	23.06.2022
4	11.3%	10090_4558-04	15.02.2023	52,600	52,400	25.04.2023
5	18.0 %	10090_4558-05	29.06.2023	83 ,700	83,700	27.07.2023
6	19.0 %	10090_4558-06	27.10.2023	88,134	88,134	30.11.2023
7 ( D shërbime )	100.0 %	10090_4558-07	21.11 2023	46,824	46,824	05.12.2023
<b>TOTALI i faturuar / i paguar</b>				<b>511,258</b>	<b>510,908</b>	

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

### TVSH

Në lidhje me rimbursimin e TVSH-së nga KESH ka rezultuar se:

Punëdhënësi rimburon taksat e paguara pas paraqitjes së provave sipas nenit 2.4.2. i Kushteve të Përgjithshme ku parashikohet pagesa e taksave nga Punëmarrësi.

Nga auditimi rezulton se pagesa e TVSH është kryer kundrejt paraqitjes së faturave të TVSH dhe pa sjell prova për pagesën e saj.

### Zbatimi i kontratës: “Implementimi i Qendrës së kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e lumit Drinit”

Pas nënshkrimit të Kontratës DMDC nga KESH dhe K. më 26.07.2022, GTAI publikoi njoftimin e dhënies së Kontratës më 29.07.2022. Konsulenti i dorëzoi njoftimin e Datës së fillimit (15.09.2022) K. më 06.09.2022.

Takimi fillestar me K. u zhvillua më 21/22.09.2022 në Tiranë. Gjatë fazës së projektimit të konceptit, Kontraktori duhej të ofronte një Projekt funksional, ku duhet të përshkruhej realizimi i të gjitha kërkesave të deklaruara në specifikimet teknike të kontratës të ofruara nga Kontraktori.

Një version i parë i projektit u dorëzua nga K. më 31.10.2022, dhe u diskutua në kuadër të një seminari për dizajnimin e Konceptit në Tiranë nga data 15 deri më 18 nëntor 2022. K. paraqiti disa rishikime të projektit, të cilat u shqyrtuan dhe u komentuan nga Konsulentët dhe KESH. Së fundmi, Konsulenti i paraqiti K. miratimin e tij me kusht të rishikohej dhe pas ndryshimeve u pranua.

Testi i Pranimi në Fabrikë u zhvillua në ambientet e testimit të K. në Zagreb, Kroaci, nga data 27 deri më 31.03.2023. Pas shkëmbimit të një dokumenti përmbledhës të draftit të FAT-së, rev. 2 u nënshkrua nga Konsulentët më 20.04.2023.

Dorëzimi i komponentëve të pajisjeve DMDC u zhvillua midis datave 27.04,2023 dhe 29.06.2023. Trajnime të ndryshme (të përgjithshme, teorike, specifike për projektin) u mbajtën nga K. në ambientet e tyre në Zagreb, si dhe në selinë qendrore të KESH në Tiranë në afatin kohor Maj-Shtator 2023. Dokumentet e detajuara të projektimit u dorëzuan nga K. më 29.05.2023 për HEC Vau i Dejës, më 30.06.2023 për HEC Fierza, më 17.08.2023 për HEC Komani dhe më 17.10.2023 për DMDC-të (DMDC kryesore dhe rezervë). Testi i Pranimi të Vendndodhjes (SAT) për pajisjet DMDC me KESH dhe K. në Tiranë u zhvillua nga 22.-25.08.2023, i ndjekur nga një SAT i dytë në selinë e përbashkët të A. Switzerland Ltd dhe Spanjë.

Në Tiranë nga data 27-28.09.2023, K. dorëzoi përmbledhjen e përditësuar të testit të pranimi më 29.09.2023. Takimet për përgatitjen e fundit të periudhës së provës dhe shqyrtimin e listës së testeve u zhvilluan më 24.10.2023 dhe 26.10.2023. Operacioni për testimin përfundimtar u krye më 27.10.2023 dhe certifikata e marrjes në dorëzim iu lëshuan nga KESH, shoqërisë K..

**Tabela nr.17**

Përshkrimi	%	Data e faturës	Faturuar në shumën neto EUR	Shuma kumulative (EUR)	Nr. i IPC-së	IPC datë
Parapagesa	10%	28.09.2022	138'425.22	138'425.22	AP	04.10.2022
Testi i fabrikës	20%	28.04.2023	276'850.45	415'275.67	1	25.05.2023
Verifikim në fabrikë	20%	30.06.2023	276'850.45	692'126.12	2	21.07.2023
Kompletimi	30%	31.10.2023	415'275.67	1'107'401.79	3	02.11.2023
Pagesa Përfundimtare	20%	31.10.2023	276'850.45	1'384'252.24	FP	02.11.2023
<b>Totali</b>	<b>100%</b>		<b>1'384'252.24</b>	<b>1'384'252.24</b>		

**Burimi i të dhënave: KESH SHA**

## TVSH

Në lidhje me rimbursimin e TVSH-së nga KESH ka rezultuar se pagesa e TVSH është kryer kundrejt paraqitjes së faturave të TVSH dhe pa dokumente justifikuese për deklarimin dhe pagesën e saj.

Sa më sipër është në kundërshtim me sa vijon:

-Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Procedural Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3 “Legjislacioni tatimor” përcakton se: “*legjislacioni tatimor përbëhet nga: a)marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi; b) ligjet tatimore; c) aktet nënligjore, të miratuara në mbështetje të ligjeve tatimore*”.

- Ligjin Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 86-88, ku përcaktohet se: “*Neni 86, Personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së*

*1.TVSH-ja paguhet nga ana e personit të tatueshëm që kryen një furnizim mallrash ose shërbimesh të tatueshëm, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.*

2. TVSH-ja është e pagueshme nga personi i tatueshëm ose personi juridik i patatueshëm, i identifikuar për TVSH- në, të cilit i janë furnizuar shërbimet, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 24, të këtij ligji, nëse këto shërbime furnizohen nga një person i tatueshëm që nuk është i vendosur në territorin e Republikën e Shqipërisë. Ministri i Financave përcakton me udhëzim procedurat për zbatimin e kësaj pike.

3. TVSH-ja paguhet nga çdo person, i cili e shënon TVSH-në në një faturë.

4. Kur fatura e lëshuar nuk përkon me furnizimin e mallit apo me kryerjen e shërbimit ose tregon një çmim që nuk duhet të paguhet efektivisht nga blerësi, TVSH-ja paguhet nga personi që e ka faturuar atë.

5. Në import TVSH-ja paguhet nga personi ose personat përgjegjës për pagesën e detyrimeve doganore në import, siç përcaktohet në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

6. TVSH-ja paguhet nga personi, i cili çliron mallrat për qarkullim të lirë nga regjimet e përcaktuara në nenet 64 dhe 65, të këtij ligji.

7. **Personi i tatueshëm, për të cilin është kryer një furnizim malli ose shërbimi dhe që ka dijeni ose nuk mund të mohojë faktin që TVSH-ja për t'u paguar ose pjesë e kësaj TVSH-je mbi këtë furnizim ose mbi të gjitha furnizimet e mëparshme të mallrave a shërbimeve, nuk është paguar për shkak të mashtrimit, është përgjegjës bashkë me furnizuesin për pagesën e TVSH-së.** “

-Nenin 63 të Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015, “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që përcakton se: “Kur projekti realizohet nga sipërmarrës të kontraktuar nga njësia zbatuese Në këtë rast, në kuadër të zbatimit të projektit, është shoqëria sipërmarrëse e punimeve, e cila për zbatimin e projektit sipas kontratës zbaton TVSH-në mbi vlerën e punimeve, shërbimeve apo furnizimit të mallrave të kryer. Shoqëria sipërmarrëse nga TVSH-ja e faturuar zbrit TVSH-në e paguar në blerjet që ka bërë për këtë qëllim, të përballuar nga vetë ajo dhe diferenca përfaqëson TVSH-në e pagueshme nga kjo shoqëri, TVSH-ja, e cila deklarohet dhe paguhet sipas ligjit. Faturën origjinale të shitjes, së bashku me situacionin e punimeve, shoqëria sipërmarrëse e punimeve ia paraqet njësisë zbatuese të projektit.

**TVSH-ja përballohet nga përfituesi vendës i projektit si kosto lokale**

Kryerja e punimeve, furnizimi i mallrave apo i shërbimeve për zbatimin e projekteve do të ngarkohet kurdoherë me TVSH-në, e cila në çdo rast do të paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e kontraktuar për zbatimin e projektit. Por kjo TVSH do t'i jepet atij përkundrejt paraqitjes së faturës (situacionit) me TVSH-në nga burime të brendshme të financuara nga kosto lokale sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 12.8.1996. Kështu, kur donatori nuk merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së, do të veprohet në përputhje me VKM-në nr. 509, datë 12.8.1996.”

**Në bazë të këtij vendimi, TVSH-ja financohet nga përfituesi apo investitori vendës i projektit dhe paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e punimeve për zbatimin e projektit.**

-Me qëllim zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve/konventave për eliminimin e taksimit të dyfishtë në zbatim të Udhëzimit Nr. 6, datë 10.02.2004 “Për Marrëveshjet Bilaterale për Shmangien e Taksimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal”, tatimpaguesi duhet të aplikojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duke depozituar dokumentacionin:

- Originalin e Formularit e aplikimit të marrëveshjes për eliminimin e taksimit të dyfishtë origjinal, të nënshkruar dhe të vulosur nga përfituesi i të ardhurave dhe autoriteti tatimor i huaj.
- Kopjen e kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar me shoqërinë jo rezidente në Republikën e Shqipërisë, të njehsuar me origjinalin dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe.
- Kopje të faturave që janë objekt aplikimi.
- Dokument të nënshkruar nga banka urdhëruese që vërteton kryerjen e pagesave të faturave objekt aplikimi (swift etj.), në të cilën të evidentohet se për cilën prej faturave objekt aplikimi

është kryer pagesa.

- Informacion nëse ka pasur prezencë fizike të stafit të shoqërisë së huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve. Nëse ka pasur prezencë fizike, të saktësohet kohë qëndrimi i personelit në Republikën e Shqipërisë. Ky informacion duhet të përfshijë emrin, mbiemrin dhe periudhën e qëndrimit në Shqipëri për secilin prej pjesëtarëve të stafit të shoqërisë së huaj (jo rezidente në Republikën e Shqipërisë), shoqëruar me dokumentet justifikues.

Në rast mos aplikimi për zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare për shërbimet e përfuturara nga shoqëritë jo rezidente në Republikën e Shqipërisë, duhet të zbatohen dispozitat e ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar.

-Referuar metodologjisë së punimeve të realizuar u konstatua se është devijuar (tharë apo bllokuar) tuneli i shkarkimit të ujerave, me qëllim riparimet dhe vendosjen strukturave të portave (Saldime, bashkime, montime etj.) dhe më pas është mbuluar nga uji. Pas riparimeve të strukturave të portave, kontrollet apo verifikimet realizoheshin vetëm me polubar, sipas specifikimeve teknike dhe dokumenteve të tenderit.

### **Marrja në dorëzim nga KESH SHA.**

Nga ana e KESH Sha nuk u vendos në dispozicion në lidhje me procedurat e marrjes në dorëzim, si urdhra pune, relacione etj.

Sa më sipër procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve nuk është në përputhje me nenet dhe pikat 42, 43 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 315/5, datë 08.10.2025, “Deklaratë e njohjes dhe komentet përkatëse mbi projekt-raportin”.

### **Pretendimi i subjektit:**

*Pasi u njohëm me projekt raportin paraqiten pretendimet e pasqyruara në të duke ju argumentuar si më poshtë vijon: Referenca e cituar: Analiza e përputhshmërisë së realizimit Projekti ViD “Të gjitha ndërhyrjet në digën anësore dhe shkarkuesin u realizuan sipas standardeve teknike. Një pjesë e ndërhyrjeve të planifikuara u pezulluan për shkak të mungesës së financimeve shtesë” Asnjë ndërhyrje e planifikuar në lidhje me rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe mirëmbajtjes nuk është pezulluar për shkak të mungesës së financimeve shtesë. Në dokumentacionin e tenderit është përkrahur termi “optional” dhe për këtë është kërkuar një ofertë por që nuk është një detyrim kontraktual për zbatim.*

*-Gjithashtu paraqiten pretendimet e pasqyruara në të duke argumentuar si më poshtë vijon:: Së pari: komentet shoqërues të ofertave nuk mund të hapen dhe të protokollohen pasi humbet konfidencialiteti dhe procedura tenderuese. Se dyti: Ky dokumentacion hapet vetëm në prani të komisionit të vlerësimit të ofertave në orën dhe datën e caktuar në ftesën për oferte, komisioni i cili ka përpiluar dhe firmosur protokollin e hapjes së ofertave dhe e ka dërguar menjëherë pranë Bankës Gjermane për Zhvillim dhe Rindërtim KfW. Për me tepër NJMP ka kundër firmosur shkresë konfirmimi për dorëzimin e paketës tenderuese në vendin dhe orën e caktuar me përfaqësuesit prezent të kompanive pjesëmarrëse në procedure. Së treti: Kopje e dokumentacionit të ofertës sipas procedurës dhe ftesës për oferte dërgohet zyrtarisht pranë KfW dhe Agjentit të tenderit kontraktuar nga Banka në orën dhe datën e caktuar me pare, dhe si rrjedhojë Banka konfirmon saktësinë e proces verbalit të hapjes së ofertave hartuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave. Ndryshe ofertat që paraqiten jo në vendin dhe jo në kohën e duhur nuk janë të vlefshme. Në çdo rast Banka KfW ka miratuar dhe aprovuar të gjithë procedurat e ndjekura nga NJMP gjatë fazës së pare dhe të dyte të vlerësimit.*

*-Analiza e përputhshmërisë së realizimit Projekti ViD “Të gjitha ndërhyrjet në digën anësore dhe shkarkuesin u realizuan sipas standardeve teknike. Një pjesë e ndërhyrjeve të planifikuara u pezulluan për shkak të mungesës së financimeve shtesë” Se pari: Asnjë ndërhyrje e planifikuar në lidhje me rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe mirëmbajtjes nuk është pezulluar për shkak të mungesës së financimeve shtesë. Në dokumentacionin e tenderit është përshkruar termi “optional” dhe për këtë është kërkuar një ofertë por që nuk është një detyrim kontraktual për zbatim.*

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me pretendimet tuaja, ju sqarojmë se nuk keni sjellë fakte të reja, dokumentacion të ri justifikues apo argumente shtesë në lidhje me konstatimet e bëra e të trajtuara në Projekt-Raport.

Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në bazë të marrëveshjes së huasë është lidhur Marrëveshje e Nënhuasë nr. 7551/2, datë 06.01.2016 midis Ministrisë së Financave dhe KESH SHA ku detyrimet financiare të parashikuara në marrëveshje (pagesa e huasë, interesit, komisioneve dhe afatet përkatëse) i kanë kaluar KESH SHA.

Disbursimi i huasë nuk është kryer në afatet e parashikuara dhe për këtë arsye është miratuar ndryshimi i skedulit të pagesave dhe kësteve me VKM-në nr. 405, datë 19.06.2019 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndryshuese të Huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe KfW-së (Huadhënësi)...” .

Konstatohet se Marrëveshja e Nënhuasë nuk ka ndryshuar dhe reflektuar ndryshimet që kanë ndodhur në Marrëveshjen e Huasë për sa i përket riskedulimit të pagesës së kësteve dhe afatet përkatëse duke sjellë një jo koherencë mbi detyrimet që KESH SHA ka ndaj buxhetit të shtetit për këtë hua. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 8 - 11 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të marrë masa për reflektimin e të gjitha ndryshimeve të marrëveshjes së huasë në marrëveshjen e nënhuasë, me qëllim që të sigurohet pagesa e tyre në vijimësi nga ana e KESH SHA.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit për realizimin e procedurave të prokurimit, u konstatua se ofertat e operatorëve nuk janë dorëzuar në protokollin e shoqërisë si dhe nuk dokumentohet koha e dorëzimit në KESH SHA, por ato i janë dorëzuar Drejtorit të PMU.

Mungesa e evidentimit të informacionit të mbërritjes në afatet e parashikuara të dokumentacionit parakualifikues, dorëzuar nga shoqëritë konsulente konkurruese, në procesin e protokollimit sipas kërkesave të KfW, vështirëson vlerësimin mbi përmbushjen e afatit të dorëzimit nga të gjitha subjektet pjesëmarrëse.

Në raportin përkatës të vlerësimit të fazës së dytë, anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk kanë evidentuar numrin e protokollit hyrës të KESH SHA dhe as datën kur janë marrë në dorëzim nga PMU, për secilën nga ofertat e dorëzuara. Vlerësimi teknik nga anëtarët e komisionit të vlerësimit është kryer me një vonesë kohore të konsiderueshme nga data e dorëzimit të ofertave deri në përfundimin e vlerësimit financiar për rreth 18 muaj. Megjithëse dokumentacioni i

KfW-së nuk parashikon një afat specifik për këtë proces, kjo vonesë është e pajustificueshme, e cila ka ndikuar në shtyrjen e përzgjedhjes së konsulentit përtej afateve të parashikuara për këtë projekt dhe realizimin e tij. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 19-43 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë të monitorojë respektimin e urdhrave dhe aktet përkatëse të miratuara prej saj, me qëllim që të forcohet kontrolli mbi zbatimin e tyre dhe mbi komisionin e vlerësimit në veçanti, duke përmirësuar procesin e vlerësimit teknik dhe financiar të ofertave, si dhe duke përcaktuar afate të qarta për finalizimin e tij, për të siguruar që procesi të përmbyllet brenda një periudhe të arsyeshme, në mënyrë që të shmangen vonesat e pajustificuara që ndikojnë në ecurinë e projektit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2.2. Rekomandimi:** Zyra e Protokollit të Korporatës Elektroenergjitike të Shqipërisë të dokumentojë procesin e dorëzimit dhe administrimit të dokumentacionit si në fazën e parë dhe të dytë, duke mbajtur një procesverbal të detajuar të dorëzimit të dokumentacionit nga shoqëritë pjesëmarrëse. Kjo do të sigurojë transparencë dhe gjurmueshmëri të plotë të dokumentacionit dhe do të mundësojë verifikimin e saktë të afateve të dorëzimit, në përputhje me kërkesat e KfW.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës së konsulencës midis KESH SHA dhe F, me nr. 200966531, datë 22.11.2017, rezulton se kontrata është ndryshuar 5 herë duke ndryshuar vlerën fillestare nga 372,000 euro në 1,526,204 euro dhe duke e zgjatur afatin nga 10+6 muaj në 96 muaj. Ndryshimet sa më sipër kanë deformuar procesin e prokurimit për sa i përket kohëzgjatjes së shërbimit dhe vlerës së tij duke ndikuar në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës konstatohet se nga ana e KESH SHA nuk është kryer monitorim mbi përmbushjen e zërave të preventivit dhe nuk është hartuar ndonjë raport për këtë çështje sipas Preventiv “Price Breakdown” bashkëlidhur kontratës dhe amendimeve, në lidhje me stafin dhe kohën, si dhe mjetet dhe sasitë e angazhuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 14-19 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë të marrë masa në të ardhmen që planifikimi i projekteve me financim të huaj të kryhet në përputhshmëri me objektivat kryesore duke vlerësuar afatet dhe kostot si dhe mbikëqyrjen nëpërmjet strukturave monitoruese për plotësimin e kushteve të kontratave si në vlerë, afate dhe cilësi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në procesin e zbatimit të kontratës së konsulencës midis KESH SHA dhe F, me nr. 200966531, datë 22.11.2017, rezulton se Korporata Elektroenergjitike Shqiptare bazuar në nenin 2.4, “Taksat” të Kushteve të Veçanta, ka rimbursuar TVSH e faturave të konsulentit, pa disponuar dokumente justifikuese për deklarime dhe pagesën e saj.

- Për zbatimin e projektit “Implementimi i Qendrës së kontrollit dhe monitorimit të HEC-eve në kaskadën e Drinit” është lidhur kontrata e Konsulencës me A., Zvicer, në të cilën për periudhën 2019-2023 ndaj kompanisë janë paguar 11,673,731 lekë për TVSH e rimbursueshme. Nga auditimi konstatohet se KESH SHA ka kryer rimbursimin e TVSH bazuar në faturat e konsulentit, pa disponuar dokumente justifikuese për deklarime dhe pagesën e saj. Nga Njësia e Zbatimit të Projektit nuk janë mbajtur relacione për prezencën fizike të stafit të shoqërive të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve, duke saktësuar kohën e qëndrimit për secilin prej pjesëtarëve të stafit të huaj, shoqëruar me dokumentet justifikues për të përfituar shmangien nga tatimi i dyfishtë.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3 “Legjislacioni tatimor”, nenin 63 të Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015, “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 6, datë 10.02.2004 “Për Marrëveshjet Bilaterale për Shmangien e Taksimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal’. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqe nr. 14-19 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë të marrë masa në të ardhmen që procesi i pagesës së TVSH-së së rimbursueshme të kryhet nga Njësia e Zbatimit të Projekteve dhe Drejtoria Ekonomike, bazuar në relacionet e monitorimit dhe dokumentet justifikues të kohës së qëndrimit të anëtarëve të stafit të huaj për shërbimet e konsulencës.

*Në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Referuar marrëveshjes të huasë, Huamarrësi do ta shlyejë huanë në 13 këste të barabarta gjashtëmujore në secilën datë të pagesës së interesit. Nga auditimi rezulton se Ministria e Financave ka filluar pagesat e interesit në vitin 2018 dhe të principalit në vitin 2021, duke shlyer deri në datën 31.12.2024 për interesin vlerën 370,584 euro, për principalin vlerën 12,307,692 euro, si dhe 594,998 euro për komisione. Në bazë të marrëveshjes së nënhuasë Nr. 7551/2, datë 06.01.2016 pagesat e sipërcituara janë detyrim i KESH SHA dhe mos shlyerja e tyre ka krijuar një detyrim të mbartur ndaj Ministrisë së Financave në vlerën **13,273,274** euro.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Marrëveshjen e Nënhuasë si dhe kanë ngarkuar buxhetin e shtetit me kosto ekstra dhe detyrime të cilat duhet t’i mbulojë KESH SHA.

Referuar pikës 3.4 “Në rast mos shlyerje të detyrimit Ministria e Financave rezervon të drejtën e konfiskimit të të ardhurave nga shitja e energjisë”, pra mos pagesa e detyrimeve të kredisë e ekspozon KESH SHA ndaj pasojave financiare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqe nr. 14-19 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marri masa për hartimin e një marrëveshje dhe skeduli për kryerjen e pagesave të detyrimeve të prapambetura të kësaj kredie.

*Menjëherë*

**5.2 Rekomandimi:** Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë të marrë masa për parashikimin e fondeve për shlyerjen e huasë dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja në programin e saj ekonomik dhe financiar.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se për shkak të zgjatjes së afatit të zbatimit të projektit, mos disbursimit në kohë dhe jo sipas skedulit të parashikuar në marrëveshjen e financimit të huasë të fondeve të vendosura në dispozicion, Ministria e Financave ka paguar ndaj KfW vlerën prej 382,498 euro komisione disbursimi, e cila është kosto shtesë për Ministrinë së Financave dhe KESH SHA. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqe nr. 14-19 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë të marrë masa që në implementimin e projekteve me financim të huaj t’i përmbahet grafikut kohor të zbatimit të tij me qëllim eliminimin e efekteve financiare në rritjen e kostos së tij.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të marrëveshjes së huasë dhe ndryshimeve të saj, rezulton se projekti është zgjatur më shumë se 6 vite, janë bërë 4 shtyrje të afatit të disbursimeve dhe në të gjitha rastet aprovimi i shtyrjes së afatit nga KfW ka ardhur pas mbarimit të afatit të disbursimit të huasë duke e ekspozuar projektin ndaj riskut të mos vijimit dhe përmbushjes së objektivave të tij.

Me email-in e datës 13.06.2022 KfW ka kërkuar për pagesë shumë prej 48,103 euro, e shlyer nga KESH SHA datë 27.06.2022 si kosto rifinancimi e huasë. Rezulton se për shkak të zgjatjes së zbatimit të projektit, KESH SHA është ngarkuar me kosto shtesë në vlerën 48,103 euro. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqe nr. 14-19 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë të marri masa për parashikimin grafik të të gjitha aktiviteteve të projektit me afate konkrete dhe objektive, si dhe të marrë masa për zbatimin e tij duke eliminuar kostot e rifinancimit nga huadhënësi.

*Në vijimësi*

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, në nenin 37, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i KESH SHA, të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë disiplinore për veprimet e kryera nga drejtuesi i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve F.B. duke nisur procedurat për dhënien e masave disiplinore, në përputhje me kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënieve përkatëse të punës.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve të Sigurisë, Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.*

*Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**